

# **PARTNERITETI PER QEVERISJE TE HAPUR (OGP)**

## **PLANI KOMBETAR OGP PER SHQIPERINE 2022- 2024/NATIONAL ACTION PLAN FOR ALBANIA**

**2022 – 2024**

### **RAPORTI NE KUADER TE PROCESIT TE BASHKEBERJES/CO-CREATION**

#### **LISTA E PRIORITETEVE TE IDENTIFIKUARA**

**22.11.2022 – 20.01.2023<sup>1</sup>**



---

<sup>1</sup> Në përputhje me shkresën MSHSSH Nr.6493.Prot, date 22.11.2022 dhe Planit të Punes të dorëzuar me shkresë si dhe publikuar në faqen [ogp.gov.al](http://ogp.gov.al)

**Procesi i bashke-berjes i ndjekur nga institucionet ne perputhje me shkresen e MSHSSH Nr.6493.Prot, date 22.11.2022 me lende “Mbi procesin e hartimit te PKV OGP 2022-2024”<sup>2</sup>**

**Ministria e Drejtësisë (2 angazhime)**

**Agjencia per mbeshtetjen e shoqerise civile**

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi,
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit.

Ministria e Drejtësisë do të prezantohet dhe do të angazhohet në PKV të OGP 2022-2024, me dy drejtime kryesore, angazhime prioritare në fushën e rritjes së ndërgjegjësimit të publikut të gjerë për mekanizma dhe instrumenta që përdoren nga publiku i gjerë në fushën e antikorrupsionit (I) dhe të aksesit në drejtësi (II).

Angazhimet janë të ndërlidhur fort me:

- Zbatimin e Reformës në Drejtësi;
- Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND);
- Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur (SDM);
- Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP);
- Strategjinë Ndërsektoriale Anti-Korrupsion (SNKK);
- Gjetjet e **Raportit të Komisionit Evropian** për Shqipërinë;

Masa të tjera të ndërmarra nga Qeveria në përmbushje të misionit të saj për një qeverisje të hapur, transparente dhe llogaridhënëse.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut dhe grupeve të interesit për çështje të aksesit në drejtësi (I) dhe se si qytetarët mund të përdorin mekanizma për të përfituar këtë të drejtë dhe të antikorrupsionit dhe të mekanizmave që mund të përdoren për denoncimin e rasteve korruptive (II) janë tashmë prioritete të MD dhe që duhen promovuar më tej.

Promovimi dhe edukimi i publikut janë me rëndësi sepse lehtësojnë veprimtarinë e institucioneve publike dhe bashkëpunimin e tyre me qytetarët në ushtrimin e fushës së përgjegjësisë dhe angazhieme të transparente dhe të mira efektivisht.

Transparenca në përdorimin e këtyre mekanizmave është e shtuar gradualisht dhe e mbështetur në dokumenta të tjera strategjike që drejtohen nga MD, por përfshirja në mënyrë eksplicite në PKV të OGP për vitet 2022-2024 i jep një vlerë të shtuar angazhimit konkret.

Me miratimin e SND së re, 2021-2025, me rishikimin e planit të veprimit antikorrupsion 2020-2023, u theksua rëndësia e zbatimit të këtyre instrumenteve dhe aplikimin e tyre në

---

<sup>2</sup> Procesi i identifikimit të prioriteteve është kryer në përputhje me standartet OGP në kuadër të procesit të bashkeberjes. Te gjitha evidencat do të paraqiten tek anetaret e Komitetit OGP si dhe në publikohen në faqen [ogp.gov.al](http://ogp.gov.al)

mënyrë të evidentuar nga Ministria e Drejtësisë së bashku me partnerët e saj, autortetet e tjera publike dhe më gjerë. Ministria e Drejtësisë si autoriteti kryesor ekzekutiv i politikave të drejtësisë si dhe gjithashtu në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, është institucioni lider që inicion dhe drejton edukimin, informimin dhe ndërgjegjëzimin e publikut për të dyja këto fusha vepritarie.

### ***Anketim i kryer ne kuader te procesit te bashkeberjes***

Pyetjet në përbërje të pyetësorit janë për të evidentuar procesin dhe rëndësinë e pasjes së këtyre proppozimeve dhe instrumenteve në ushtrimin e veprimtarisë së MD, për të siguruar aksesin në drejtësi dhe në luftën kundër korrupsionit në administratë; qëllimi është për të kuptuar se kush mund të përfshihen në hartimin dhe ndjekjen për të garantuar zbatimin e tyre; si mund të përthithet asistenca dhe bashkëveprimi me organizata të shoqërisë civile, si edhe fushat konkrete ku ato mund të bashkëpunojnë.

Këto pyetje janë përzgjedhur për të mundësuar ndërveprimin dhe garantuar bashkëpunim për hartimin dhe zbatimin e nismave sa më të mira dhe eficiente bashkëpunimi të ndërgjegjësimit dhe informim por edhe edukim të publikut të gjerë.

### ***Cili është rezultati i pritshëm i sondazhit:***

Të garantohet dhe mundësohet bashkëpunim për të evidentuar rëndësinë e përdorimit të masave ndërgjegjësuese dhe edukuese, të nismave të bashkëpunimit dhe të përfshirjes të partnerëve jastë qeverisë në to.

### ***Përzgjedhja e palëve të interesuara:***

*Si u përzgjedhën palët e interesuara?*

Lista e adresave/kontakteve drejtuar pyetësori (sondazhi) për bashkë-bërje të masave prioritare është hartuar në bazë të bashkëpunimit të drejtoive teknike pranë MD dhe të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në fushën e politikave të drejtësisë dhe të Antikrrupsionit.

MD ka një forum bashkëpunimi me organizata dhe akademinë në fushën e politikave të drejtësisë, edukimit ligjor, etj. Fusha e drejtësisë është një sektor me interes dhe ka ndëveëprim me OSHC vazhdimisht.

MD/KKK konsulton dokumentet e saj të politikave AK me OSHC, ka të konstituuar Forumin e Shoqërisë Civile për AK, pranë saj. Në këtë rrjet janë OSHC me aktive e fushën AK.

### **Rezultatet**

*Përmbledhje e të dhënave të marra nga palët e interesuara:*

Nga procesi i parakonsultimit në linkun në të cilin është shpallur anketa/pyetësor rezulton një feedback paksa i kufizuar. Janë vetëm një organizatë, një akademikë, dhe 3 institucione publike që kanë aksesuar pyetësorin dhe kanë adresuar përgjigje për pyetjet dhe kërkesat e shtruara, në adresën e kontaktit të vënë në dispozicion.

*Çështjet kryesore të identifikuar nga palët e interesuara:*

Pjesëmarrësit në pyetësor kanë dakordësuar propozimet e MD.

Propozime të reja ka pasur edhe për përfshirje si:

- planet e integritetit tek varësite e ML-ve
- të dhëna me bazë gjinore në institucionet publike
- kuadri ligjor për financimin e partive politike.

*Rekomandimet kryesore të palëve të interesuara:*

OSHC janë kryesisht dakord me propozimet e dhëna nga MD për dy angazhimet prioritare.

### **Takime pune dhe tryeza diskutimi për procesin e hartimit të PI por dhe për zbatimin e dokumentit.**

Rishikimi i ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe disa akteve ligjore në zbatim të tij për të rritur efektivitetin dhe përmirësuar zbatimin e këtij ligji në veçanti për pjesën e garantimit të ndihmës ligjore për kategoritë e veçanta, por edhe çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e sistemit në tërësi, përfshirë edhe angazhimin e OSHQ të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike. Disa çështje që kërkojnë ndryshime ligjore janë: thjeshtimi i procedurave për përfitimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore; autorizimi i i OJF edhe ofrimin e ndihmës dytësore; thjeshtimi i procedurës për financimin e OJF-ve; rregullimi ligjor i shërbimeve “probono” si mekanizma alternativ për ndihmë juridike falas dhe pa kosto edhe për shtetin; rritja e efektivitetit të ofrimit të ndihmës dytësore nga avokatët e dhomave vendore; si dhe çështje të tjera që rezultojnë me problema nga praktika e deritanishme.

OSHC duhet të mbështeten me fonde shtetërore për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore.

Duhet rritur bashkëpunimi me OSHC që ofrojnë shërbime ligjore për kategoritë në nevojë dhe të përmirësohet kuadri ligjor që rregullon rolin e OSHC-ve në këtë fushë.

Duhet zhvilluar fushata ndërgjegjësimit për informimin e shoqërisë dhe në veçanti të grupeve në nevojë për të rritur aksesin në drejtësi dhe për të informuar ata për të drejtat që kanë për ndihmë ligjore falas.

Duhet zhvilluar trajnime me punonjës të administratës në nivel vendor për të rritur kapacitetet e tyre si shërbim ofrues të ndihmës ligjore por edhe si referues të rasteve me nevoja ligjore.

Duhet përmirësuar sistemi dhe mekanizmat vendor të referimit të rasteve për shërbime ligjore.

*Kufizimet në përgjigjet / nën-përfaqësimin e palëve të interesuara:*

*Nga 70 organizata, akademi dhe të ftuar, vetëm 5 kanë kthyer përgjigje.*

### **Pergatitjet për fazat e ardhshme**

*Çfarë duhet përmirësuar në fazat e ardhshme?*

*Drafti i PV do të rishikohet me qëllimin për të modifikuar masat ekzistuese të propozuara nga MD, dhe/apo hartuar të reja duke marrë si indicie të mundshme kontributin e marë nga procesi i parakonsultimit të deritanishëm.*

*Si do të sigurohet bashkëpunimi me takimet?*

Do të planifikohen takime konsultimi dhe drafti do të shpërndahet paraprakisht për mendime dhe komente tek OSHC-të.

## **Takim konsultativ me shoqerine civile**

Consultation Details	
Policy Goal Focus	<p>Angazhime të propozuara nga Ministria e Drejtësisë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi;</li> <li>Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit.</li> </ol>
Lead Focal Point Institution	<ul style="list-style-type: none"> <li>Znj. Elona Hoxha/Drejtor Drejtorie, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë.</li> <li>Znj. Rovena Pregja / Përgjegjës Sektori, Sektori i Planifikimit dhe Monitorimit Strategjik në Fushën Antikorrupsion.</li> </ul>
Date	12.01.2023
Consultation Meeting Number	1
I. Objective of Consultation Meeting	
<p><b>What was the aim of this consultation?</b>  <b>Please answer for all that apply</b></p>	<p><b>Details:</b></p> <p>Takimi i parë synoi të orientojë të gjithë përfaqësuesit e institucioneve publike të thirrura në takim (MD dhe institucione publike; Kryeministria) dhe OSHC-t, lidhur me procesin e bashkërendimit në kuadër të Planit të Punës për përgatitjen e PKV 2022-2024, si dhe të garantojë përfshirjen e grupeve të interesit, kryesisht të organizatave të shoqërisë civile, akademisë dhe çdo të interesuari në hartimin dhe konsolidimin e komponentëve të planit kombëtar të OGP, me qëllim marrjen e komenteve dhe propozimeve konkrete lidhur me përfundimin e masave dhe aktiviteteve të reja në funksion të angazhimeve të propozuara.</p> <p>Qëllimi i konsultimit është diskutimi dhe dakordësimi i pyetësorit –sondazh për përcaktimin e angazhimeve prioritare të Ministrisë së Drejtësisë në PKV 2022-2024 dhe të rolit të përfshirjes së OSHC-ve në to.</p>
(i) Introduce stakeholders to the proposed policy goal	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes

Ministria e Drejtësisë në kuadër të detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi i Shqipërisë në Partneritetin për Qeverisjen e Hapur (këtu e tutje “PQH” ose “OGP”), nisur fusha e saj e përgjegjësisë ka propozuar angazhime për secilën fushë si më poshtë:

**-Aksesi në drejtësi,** shihet si një nga komponentët kyç jo vetëm të Qeverisë Shqiptare, por edhe të Ministrisë së Drejtësisë, e ndërlidhur fort me zbatimin e reformës në drejtësi, Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë(SND),StrategjinëNdërsektoriale Antikorupsion (SNKK), Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur (SDM), Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut(SELP), si dhe masat e tjera të ndërmarra nga Qeveria në përmbushje të misionit të saj për një qeverisje të hapur, transparente dhe llogaridhënëse e cila ofron akses në cdo kohë për çdo qytetar.

Rrjedhimisht, për këtë fushë Ministria e Drejtësisë propozoi angazhimin e mëposhtëm:

- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi

**- Lufta kundër korrupsionit,** është një ndër politikat më prioritare, të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi. Parandalimi dhe ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi i publikut lidhur me luftën antikorupsion është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO), Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj. Rrjedhimisht, për këtë fushë është propozuar angazhimi:

- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat

	<p>në luftën kundër korrupsionit</p> <p>Sipas parimeve dhe standarteve të OGP, për një qeverisje të hapur, i cili bazohet në një proces <b><i>gjithëpërfshirës, të drejtë dhe transparentme</i></b> me të gjitha grupet e interesit, si dhe në përputhje me metodologjinë e ndjekur nga institucioni ynë mbi hartimin e dokumentit politik, pjesëmarrësit janë njoftuar paraprakisht për qëllimin e takimit dhe të draft dokumentit, ku është shpërndarë edhe pyetëtori për këtë qëllim.</p> <p>Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë në përmbushje të detyrave funksionale që rrjedhin nga ky proces, pas hartimit të pyetëtorit, shpërndarjes dhe publikimit të tij online, gjatë takimit, strukturat përgjegjëse, njohën pjesëmarrësit edhe me kalendarin e punës por edhe me qëllimin e pyetëtorit. Për këtë qëllim u përgatit edhe një material prezantimit PPT, bashkëlidhur këtij raporti.</p> <p>Propozimet e MD lidhen me adresimin e problematikave të ndryshme me qëllim nxitjen e transparencën qeveritare, për të rritur pjesëmarrjen qytetare në jetën publike, si dhe për të luftuar fenomenin e korrupsionit në të gjitha nivelet e ekspozimit të tij dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për mekanizmat që ofrojnë akses në drejtësi.</p>
(ii) Introduce stakeholders to the OGP process	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Po. Në Takimin e parë online konsultativ janë ftuar rreth 70 përfaqësues, të organizatave të shoqërisë civile, akademisë, institucioneve publike që kanë veprimtari institucionale të fushës, dhe aktorë të tjerë të interesuar, të cilëve iu dha informacioni i detajuar për procesin e bashkë-hartimit të PKV 2022-2024 të OGP, dhe të parimeve të nismës. Për këtë qëllim u përgatit edhe një material prezantimit PPT, bashkëlidhur këtij raporti.</p>
(iii) Explain the feedback tools for stakeholders	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Në Takimin e parë Konsultativ, i mbajtur Online nëpërmjet platformës Microsoft Teams, znj. Rovena Pregja, Përgjegjëse e</p>

	<p>Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit Strategjik në Fushën Antikorrupsion, dha një prezantim shterues të procesit të OGP, si dhe të detyrimeve dhe angazhimeve konkrete për komponentët respektivë të Ministrisë së Drejtësisë. “Ndërgjegjësimi dhe edukimi i Publikut të Gjerë mbi mekanizmat e aksesit në Drejtësi dhe Luftën Kundër Korrupsionit”.</p> <p>Pjesmarrësve në takim iu dha mundësia për të pyetur dhe për të komentuar rreth pyetësorit i cili ishte i publikuar më parë online.</p> <p>-Pyetësoni i hartuar, në kuadër të procesit të bashkë-bërjes së masave prioritare të angazhimeve të Planit Kombëtar të Veprimit, 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (en:OGP), u shpërnda, paraprakisht nëpërmjet emailit dhe u publikua në faqën zyrtare të</p> <p>MD - <a href="https://drejtesia.gov.al/publikohet-pyetesori-per-bashke-berjen-e-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur/">https://drejtesia.gov.al/publikohet-pyetesori-per-bashke-berjen-e-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur/</a></p> <p>OGP Albania - <a href="https://ogp.gov.al/faqe/pyetesori-ne-kuader-te-procesit-te-bashke-berjes-se-masave-prioritare-te-angazhimeve-te-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur-ogp">https://ogp.gov.al/faqe/pyetesori-ne-kuader-te-procesit-te-bashke-berjes-se-masave-prioritare-te-angazhimeve-te-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur-ogp</a></p>
(iv) Brainstorm ideas with stakeholders	<p><input checked="" type="checkbox"/>No / <input type="checkbox"/>Yes</p> <p>Takim konsultativ 1, nuk pati ide konkrete për përmirësimin e angazhimeve të sugjeruara nga Ministria e Drejtësisë, nga pjesëarrësit në të, dhe/apo propozime të reja.</p>
(v) Develop further details (milestones, etc.) for ideas	<p><input checked="" type="checkbox"/>No / <input type="checkbox"/>Yes</p>
(vi) Gather feedback on proposed policy goals	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Takimi i parë konsultativ, ishte në format shpjegues për të gjithë aktorët, lidhur me pyetësonin i hartuar në bazë të dy angazhimeve nga Ministria e Drejtësisë.</p>



	Kërkesës së vazhdueshme të MD për propozime të reja dhe përfshirje në angazhime prioritare, në takim, nuk iu dhanë përgjigje konkrete nga pjesëmarrësit.
(vii) Prioritize proposed policy goals	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes
(viii) Other (provide details)	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes
<b>II. Methodology</b>	
<b>What was the format of the meeting? How were stakeholders able to participate?</b>	Takimi i parë Konsultativ u organizua Online, i hapur dhe interaktive.  Microsoft Teams meeting Meeting ID: 333 566 735 474 Passcode: uLMraz
(i) Presentations	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Kuadri Metodologjik;</li> <li>✓ Prezantimi i procesit të OGP dhe i komponentëve përbërës të Planit të Veprimit për Qeverisjen e Hapur 2022 - 2024.</li> <li>✓ Parimet e OGP.</li> <li>✓ Hapat e Hartimit të Planit të Veprimit 2022 – 2024.</li> <li>✓ Kërkesa për pyetje/ndërhyrje.</li> </ul>
(ii) Discussion / Feedback from stakeholders	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Gjatë takimit u dakordësua që çdo propozim i mundshëm të dërgohet elektronikisht në adresat e kontaktit, me qëllim caktimin e angazhimeve prioritare të PKV 2022-2024.
(iii) Questions and answers	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Pjesëmarrësve iu dha mundësia për të bërë pyetje. Përfaqësuesi i AMSHC propozoi që OSHC të ishin të pavarura nga angazhimet e MD, dhe të rishikohej roli i MD në këtë nismë. Ndërkoh që MD risqaroi pozicionin e saj si institucion lider në angazhimet prioritare të propozuara.

	Përfaqësuesi i Kryeministrisë gjithashtu në ndërhyrjen e saj, dha sugjerimin dhe rikonfirmoi shpjegimet e bëra nga MD, për bashkë-bërjen e PKV nga qeveria dhe OSHC.
(iv) Brainstorming	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Pjesëmarrësve iu dha mundësia për të bërë pyetje dhe diskutuar por në këtë fazë të procesit nuk u dha angazhim konkret.
<b>Stakeholder Selection</b>	<b>Details</b>
(i) How were stakeholders selected?	Pjesëmarrësit u përzgjedhën në kuadër të bashkëpunimit që ka Ministria e Drejtësisë, gjatë procesit të hartimit të politikave në fushën e drejtësisë dhe antikorrupsionit, me OSHC, akademinë dhe aktorë të tjerë të cilët veprimtaria e tyre lidhet me këto dy fusha. Gjithashtu, pjesëmarrësit u selektuan edhe nga kontaktet dhe eksperiencat e mëparshme të ngjashme me Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim gjithëpërfshirjen në këtë proces. Thirrja dhe angazhimi i hapur publik në faqen e MD dhe në ogp.al gjithashtu patën impaktin e tyre të pjesëmarrjes në takim.
(ii) How were stakeholders contacted?	Palët e interesuara u ftuan të ishin pjesë e këtij procesi në rrugë elektronike dhe telefon. Ftesa u shoqërua edhe me agjendën e takimit, si dhe u njoftuan për plotësimin e pyetësorit dhe mënyrat e aksesimit të tij. Palët e interesuara u njoftuan edhe me publikimin në faqen e MD dhe në ogp.al.
(iii) How many stakeholders were contacted?	(Rreth) 70
(iv) Was the consultation announced publically? (via websites, social media, etc.)	Po. Procesi i parakonsultimit është njoftuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe OGP Albania. Njoftimi është kryer gjithashtu në rrugë elektronike/via-email dhe telefon.  Linket e publikimit janë: <a href="https://www.drejtesia.gov.al/publikohet-pyetesori-per-bashke-berjen-e-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur/">https://www.drejtesia.gov.al/publikohet-pyetesori-per-bashke-berjen-e-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur/</a>

	<a href="https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/Pyetesor-per-bashke-berjen-e-PV-OGP-2022-2024.pdf">https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/Pyetesor-per-bashke-berjen-e-PV-OGP-2022-2024.pdf</a>  <a href="https://www.drejtesia.gov.al/njoftime-2/">https://www.drejtesia.gov.al/njoftime-2/</a>  <a href="https://ogp.gov.al/faqe/pyetesor-ne-kuader-te-procesit-te-bashke-berjes-se-masave-prioritare-te-angazhimeve-te-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur-ogp">https://ogp.gov.al/faqe/pyetesor-ne-kuader-te-procesit-te-bashke-berjes-se-masave-prioritare-te-angazhimeve-te-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur-ogp</a>
(v) Were stakeholders reminded?	<p>Po. Palët e interesuara dhe të ftuara në këtë proces janë rikujtuar në rrugë elektronike/ via- e-mail/Telefon.</p> <p>E-mail për njoftim të takimit online datë 04.01.2023. E-mail kujtues për zhvillimin e takimit 10.01.2023. E-mail rikujtues për zhvillimin e takimit 12.01.2023.</p>
<b>III. Results/ Findings</b>	
<b>Stakeholder Contributions</b>	<b>Details</b>
(i) How many stakeholders attended?	27 pjesmarrës
(ii) Did stakeholders contribute?	Po.
(iii) Main issues identified by stakeholders	Takimi ishte konsultativ dhe gjatë takimit palëve prezent iu dhanë këshilla dhe kërkesa për propozime dhe përfshirje në angazhmet e PKV 2022-2024.
(iv) Main recommendations from stakeholders?	Ndarja e strukturës së MD si administratë shtetërore nga angazhimet e PKV 2022-2024.
<b>IV. Shortcomings Identified &amp; Preparations for Next Consultation</b>	
	<b>Details</b>
(i) Limitations in stakeholder attendance	Jo. U ftuan rreth 70 përfaqësues institucionesh, OSHC, akademia, në rrugë elektronike (email)
(ii) Limitations in stakeholder participation	Po. Organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e institucioneve të ftuar në proces ishin 27 nga 70 të ftuar.

(iii) What can be done to improve attendance?	Promovimi në rrjete sociale të angazhimit të Ministrisë së Drejtësisë.
(iv) What can be done to improve participation in the next meeting?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i një ure të përbashkët midis aktorëve të interesuar dhe Ministrisë së Drejtësisë do të ndikojë në ofrimin e propozimeve dhe kontributeve për të përmirësuar secilin nga fushat përkatëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre;</li> <li>• Inkurajim duke biseduar drejtpërdrejt me palët e interesit për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre;</li> <li>• Të ftuarëve dhe pjesëmarrësve iu kërkua plotësimi dhe dërgimi i pyetësorit dhe/apo dhënia e propozimeve në takimin e radhës, të njoftuar për në datë 17.1.2023.</li> </ul>

**Stakeholder Feedback**

<p><b>N</b> <b>a</b> <b>n</b> <b>e</b> <b>:</b></p> <p>Znj. Aida Zeneli</p>	<p><b>Organization/ Affiliation:</b></p>	<p>Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile</p>	<p><b>Position:</b></p>	<p>Specialiste e Bashkëpunimi t Ndërkombëtar</p>
<p><b>Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas</b></p>				
<p><b>Comments:</b></p> <p>Përfaqësues nga Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, bëri një ndërhyrje lidhur me rolin e Ministrisë së Drejtësisë si Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit OGP, duke sugjeruar që ky ifundit të jetë i pavaruara nga Ministrinë.</p> <hr/> <hr/> <p><b>Issues Raised: -</b></p> <hr/> <hr/>				

**Feedback:**

Znj. Pregja u shpreh se Qeveria Shqiptare ka detyrimin që gjatë hartimit të këtij dokumenti, të angazhojë përveç institucioneve publike, edhe organizatat e shoqërisë civile si partnere në hartim dhe zbatim, sipas fushës së tyre të veprimtarisë. Qëllimi dhe angazhimi kryesor i Ministrisë është që të përshijë që në fazat e para të këtij procesi shoqërinë civile dhe të bashkë-hartojë këtë plan veprimi.

<b>Name:</b>	Znj. <b>Drita Avdyli</b>	<b>Organization/ Affiliation</b> :	Dhoma Kombëtare e Njermjetësve ,	<b>Position:</b> Kryetare DHKN	Specialiste e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
<b>Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas</b>					
<b>Comments:</b> Përfaqesuesja e Dhomës Kombëtare të Njermjetësimit, shprehu vlerësimet e saj pozitive për këtë takim dhe informoj se për implementimin e masave që mund të prekin apo përshijnë DhKNd kërkohet asistencë financiare nga donatorë apo OSHC.					
<b>Issues Raised:</b> -					
<b>Feedback:</b> -					

**STAKEHOLDER ATTENDANCE (evidencat janë pjesë e aneksve të raportit)**

## Takim konsultativ me shoqerine civile

Takim konsultativ me shoqerine civile	
Consultation Details	
Policy Goal Focus	“Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në Drejtësi dhe Luftën Kundër Korrupsionit”.
Lead Focal Point Institution	<ul style="list-style-type: none"> <li>Znj. Elona Hoxha/Drejtor Drejtorie, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë.</li> <li>Znj. Rovena Prega / Përgjegjës Sektori, Sektori i Planifikimit dhe Monitorimit Strategjik në Fushën Antikorrupsion.</li> </ul>
Date	17.01.2023
Consultation Meeting Number	2
V. Objective of Consultation Meeting	
<p><b>What was the aim of this consultation?</b> Please answer for all that apply</p>	<p><b>Details:</b> Takimi i dytë pati si qëllim të përcaktonte qëllimin e politikës ku do të mbështetet PKV (OGP), dhe mbi bazën e të cilit do të vijojë hartimi kokret i Planit të ri të Veprimit 2022 - 2024, për komponentin që do të udhëhiqet nga MD.</p> <p>Garantimi i përfshirjes së grupeve të interesit, organizatave të shoqërisë civile, akademisë, ministrive të linjës si dhe çdo të interesuari në hartimin dhe konsolidimin e komponentëve të planit kombëtar të OGP.</p> <p>Rëndësia e përcaktimit të komponentit të MD-së me qëllim marrjen e komenteve dhe propozimeve konkrete lidhur me përfundimin e masave dhe aktiviteteve të reja në funksion të këtij objekti si dhe në monitorimin e zbatueshmërisë së këtij të fundit.</p> <p>Takimi konsolidoi dhe rakordoi me të gjithë pjesëmarrësit angazhimet prioritare kyç të PKV 2022-2024 , për komponentin e MD.</p>
(ix) Introduce stakeholders to the proposed policy goal	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Ministria e Drejtësisë në kuadër të detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi i Shqipërisë në Partneritetin për Qeverisjen e Hapur (këtu e tutje “PQH” ose “OGP”), nisur nga fusha e saj e përgjegjësisë ka

propozuar angazhime për secilën fushë si më poshtë:

*-Aksesi në drejtësi*, shihet si një nga komponentët kyç jo vetëm të Qeverisë Shqiptare, por edhe të Ministrisë së Drejtësisë, e ndërlidhur fort me zbatimin e reformës në drejtësi, Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë(SND), Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur (SDM), Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut(SELP), si dhe masat e tjera të ndërmarra nga Qeveria në përmbushje të misionit të saj për një qeverisje të hapur, transparente dhe llogaridhënëse e cila ofron akses në cdo kohë për cdo qytetar.

Rrjedhimisht, për këtë fushë Ministria e Drejtësisë propozoi angazhimin e mëposhtëm:

- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi

*- Lufta kundër korrupsionit*, është një ndër politikat më prioritare, të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi. Parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi i publikut lidhur me luftën antikorrupsion është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO), Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj dhe të Strategjisë Ndërsektoriale Antikorrupsion (SNKK). Rrjedhimisht, për këtë fushë është propozuar angazhimi:

- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit

Sipas parimeve dhe standarteve të OGP, për një qeverisje të hapur, i cili bazohet në një proces *gjithëpërfshirës, të drejtë dhe transparente* me të gjitha grupet e interesit, si dhe në përputhje me metodologjinë e

	<p>ndjekur nga institucioni ynë mbi hartimin e dokumentit politik, pjesëmarrësit janë njoftuar paraprakisht për qëllimin e takimit dhe të draft dokumentit, ku është shpërndarë edhe pyetësoni për këtë qëllim.</p> <p>Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë në përmbushje të detyrave funksionale që rrjedhin nga ky proces, pas hartimit të pyetësorit, shpërndarjes dhe publikimit të tij online, gjatë takimit, strukturat përgjegjëse, njohën pjesëmarrësit edhe me kalanderin e punës por edhe me qëllimin e pyetësorit.</p> <p>Të gjitha komentet dhe propozimet e marra në këtë fazë të hershme të konsultimit ishin pjesë e diskutimeve në këtë takim. Gjithësesi gjatë takimit pati pjesëmarrës të tjerë të interesuar të cilët shprehën komente dhe sugjerime/ide mbi angazhimet e propozuara nga MD.</p> <p>Kryesisht sugjerimet e tyre lidhen me adresimin e problematikave të ndryshme me qëllim nxitjen e transparencën qeveritare, për të rritur pjesëmarrjen qytetare në jetën publike, si dhe për të luftuar fenomenin e korrupsionit në të gjitha nivelet e ekspozimit të tij dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për mekanizmat që ofrojnë akses në drejtësi.</p>
(x) Introduce stakeholders to the OGP process	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Po. Në Takimin e dytë Konsultativ, i cili u mbajt fizikisht në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, u ftuan rreth 70 përfaqësues, pjesë e ministrive të linjës, të organizatave të shoqërisë civile, akademia dhe aktorë të tjerë të interesuar, të cilëve iu dha mundësia të ofrojnë opinionet dhe sugjerimet e tyre online, lidhur mbi pyetësorin e përgatitur nga Ministria e Drejtësisë.</p> <p>-Pyetësoni i hartuar, në kuadër të procesit të bashkë-bërjes së masave prioritare të angazhimeve të Planit Kombëtar të Veprimet, 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (en:OGP), u rishpërnda, paraprakisht nëpërmjet emailit dhe vijon të</p>



	<p>jetë i publikuar në faqen zyrtare të MD dhe OGP Albania, deri më datë 18.1.2023.</p> <p>takim u risollën metodologjia e hartimit të PKV të OGP dhe parimet e saj, si pjesë e prezantimit PPT, bashkëlidhur këtij raporti.</p>
<p>(xi) Explain the feedback tools for stakeholders</p>	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Në Takimin e dytë Konsultativ, i mbajtur në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, znj. Hoxha, Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në hapjen e takimit, theksoi rëndësinë e përcaktimit të komponentit i cili do të përcaktohet nga kontributi i të gjithë aktorëve në bazë të pyetësorit të publikuar online.</p> <p>Znj. Rovena Pregja, Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit Strategjik në Fushën Antikorrupsion, realizoi një prezantim shterues për procesin e ndjekur deri më tani për komponentët e OGP, si edhe prezantoi metodologjinë që do ndiqen për hartimin e detajuar të PV të OGP-së.</p> <p>Gjatë takimit të zhvilluar, OSHC dhe aktorët e tjerë pjesëmarrës, sugjeruan që të dy komponentët e vendosur nga Ministria e Drejtësisë të jenë të përfshirë në një, “Ndërgjegjësimi dhe edukimi i Publikut të Gjerë mbi mekanizmat e aksesit në Drejtësi dhe Luftën Kundër Korrupsionit”.</p> <p>Pjesëmarrësve në takim iu dha mundësia për të pyetur dhe për të komentuar rreth pyetësorit i cili ishte i publikuar më parë online dhe argumentuar propozimet e dhëna nga MD.</p>
<p>(xii) Brainstorm ideas with stakeholders</p>	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Takim konsultativ 2 pati komente dhe propozime për përfshirje në listën e angazhimeve të MD. Propozimet referuar angazhimeve si planet e integritetit në varësitë e ML-ve, financimi i partive politike dhe ngritja e të dhënave me bazë gjinore për institucionet shqiptare dhe dakordësi uniforme e të gjithë të pranishmëve për dy propozimet e</p>

	angazhimeve prioritare të dhëna nga MD (si më lart).	
(xiii) Develop further details (milestones, etc.) for ideas	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Diskutantët dhe të ftuarit dhe përfaqësuesit e MD diskutuan mbi propozimet e dhëna. Të gjithë ishin dakord përfshirjes së angazhimeve prioritare për edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për mekanizmat e aksesit në drejtësi dhe po ashtu të mekanizmave denoncues kundër korrupsionit, si mënyrë bashkëpunimi e MD dhe prioritete të veprimtarisë së tyre. Propozimet e tjera të përmendura u vlerësuan si oportune në dokumente të tjera veprimi dhe angazhimi të MD.	
(xiv) Gather feedback on proposed policy goals	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Takimi i dytë konsultativ, ishte në format shpjegues për të gjithë aktorët të cilët morën pjesë në takim, lidhur me pyetësin dhe rëndësinë e përcaktimit të komponentit të Ministrisë së Drejtësisë.  Në përfundim u dakordësuar unanimisht të dy prioritetet e MD për PKV 2022-2024.	
(xv) Prioritize proposed policy goals	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes MD do të jetë e angazhuar në këtë dokument me të dy angazhimet e vetë-proponuar prej saj.	
(xvi) Other (provide details)	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes	
<b>VI. Methodology</b>		<input type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes
<b>What was the format of the meeting? How were stakeholders able to participate?</b>	Takimi i dytë Konsultativ u organizua në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë. Natyra e takimit ishte e hapur, interaktive dhe frytdhënëse.	
(v) Presentations	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Kuadri Metodologjik;</li> <li>✓ Prezantimi i procesit të OGP dhe i komponentëve përbërës të Planit të</li> </ul>	

	<p>Veprimet për Qeverisjen e Hapur 2022 - 2024.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Parimet e OGP.</li> <li>✓ Propozimet e marra deri në këtë fazë të procesit.</li> <li>✓ Publikimi dhe përfshirja e palëve të tjera në konsultimin angazhimeve.</li> <li>✓ Hapat e Hartimit të Planit të Veprimit 2022 – 2024.</li> </ul>
(vi) Discussion / Feedback from stakeholders	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Gjatë takimit u dakordësua që çdo propozim i mundshëm në vijim, në kuadër të detajimit të angazhimeve kryesore të dërgohet elektronikisht në adresat e kontaktit, por u sugjerua gjithashtu nga drejtuesit e takimit edhe organizimi i tryezava më të vogla në format, me çdo institucion apo OSHC të interesuar me qëllim analizimin dhe detajimin në aktivitete të angazhimeve përkatëse.</p>
(vii) Questions and answers	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Pjesëmarrësve iu dha mundësia për të bërë pyetje dhe për të diskutuar. Në përgjithësi pati dakordësi lidhur me angazhimet e propozuara dhe konstatime pozitive.</p>
(viii) Brainstorming	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Pjesëmarrësve iu dha mundësia për të bërë pyetje dhe diskutuar.</p> <p>Takimi 2 u shoqërua nga diskutime për angazhimete propozuara dhe dakordësimin e tyre.</p>
<b>Stakeholder Selection</b>	<b>Details</b>
(vi) How were stakeholders selected?	<p>Ministria e Drejtësisë, për shkak të funksionit të saj si dhe shumë projekteve të ndërmarra në fushën e drejtësisë dhe antikorrupsionit ka përfshirë një gamë të gjerë të shoqërive civile, qendrave studimore, akademisë dhe juristëve të shquar. Si rrjedhojë, për këtë proces ashtu si për projektet e tjera në fushën e drejtësisë dhe të antikorrupsionit u përdor lista e shoqërive civile/grupeve të interesit të cilat kanë lidhje direkte ose indirekte me aksesin</p>

	<p>në drejtësi, transparencën dhe llogaridhënien institucionale, qeverisje e mirë dhe luftën kundër korrupsionit. Për shembull, lista e grupeve të interesit, përfshin: shoqatat civile që kanë lidhje direkte me sistemin e drejtësisë dhe prekin tema të ndryshme sociale - ekonomike si, ndihma ligjore për gratë dhe femijët apo grupet vulnerable, ndihma ligjore për rastet e dhunës në familje, shoqatat në ndihmë të minoriteteve dhe imigrantëve, po ashtu organizata të pëfshirp në mekanizma antikorrupsion dhe përfaqësues të akademisë.</p> <p>Gjithashtu, janë përfshirë fakultetet e drejtësisë së universiteteve shtetëror dhe private si dhe akademik/profesor që ushtrojnë veprimtarinë e tyre me lidhje direkte në sistemin ligjor si dhe qendra studimore dhe shoqata që merren me vëzhgimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore me synim kërkimin e llogaridhënies nga ana e qeverisë.</p>
(vii) How were stakeholders contacted?	<p>Palët e interesuara u ftuan të ishin pjesë e këtij procesi në rrugë elektronike/ telefon. Ftesa u shoqërua edhe me agjendën e takimit, si dhe të ftuarit u bënë me dije rreth pyetësorit dhe mënyrat e aksesimit të tij.</p> <p>Të ftuarit iu ricuan kujtesë email (agjendë dhe draft dokument/sondazh) të takimit.</p>
(viii) How many stakeholders Were contacted?	(Rreth) 70
(ix) Was the consultation announced publically? (via Websites, social media, etc.)	<p>Po. Procesi i parakonsultimit është njoftuar në faqen zyrtare të OGP/Albania dhe drejtesia.gov.al</p> <p>Njoftimi është kryer vetëm në rrugë elektronike/via-email dhe telefon.</p> <p><a href="https://www.drejtesia.gov.al/publikohet-pyetesori-per-bashke-berjen-e-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur/">ps://www.drejtesia.gov.al/publikohet-pyetesori-per-bashke-berjen-e-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur/</a></p> <p><a href="https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/Pyetesori-per-bashke-berjen-e-PV-OGP-2022-2024.pdf">ps://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/Pyetesori-per-bashke-berjen-e-PV-OGP-2022-2024.pdf</a></p> <p><a href="https://www.drejtesia.gov.al/njoftime-2/">ps://www.drejtesia.gov.al/njoftime-2/</a></p>

	<a href="https://ogp.gov.al/faqe/pyetesor-ne-kuader-te-procesit-te-bashke-berjes-se-masave-prioritare-te-angazhimeve-te-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur-ogp">ps://ogp.gov.al/faqe/pyetesor-ne-kuader-te-procesit-te-bashke-berjes-se-masave-prioritare-te-angazhimeve-te-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur-ogp</a>
(x) Were stakeholders reminded?	Po. Palët e interesuara dhe të ftuara në këtë proces janë rikujtuar në rrugë elektronike/ via- e-mail/Telefon. Njoftim të takimit në MD, datë 12.01.2023. E-mail kujtues për zhvillimin e takimit 16.01.2023.
<b>VII. Results/ Findings</b>	
<b>Stakeholder Contributions</b>	<b>Details</b>
(v) How many stakeholders attended?	16 pjesëmarrës
(vi) Did stakeholders contribute?	Po
(vii) Main issues identified by stakeholders	Takimi ishte konstruktiv dhe gjatë takimit nga palët prezente u dhanë disa sugjerime/ide/komente.
(viii) Main recommendations from stakeholders?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dakordësi mbi angazhimet e propozuara nga MD në këtë proces: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi</li> <li>2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit</li> </ol> </li> <li>• Nevoja për përmirësim e ligjit nr.111/2017 të Ndihmës Juridike Falas;</li> <li>• Rritja e transparencës tek shërbimet në kategoritë në nevojë, se si ofrohen këto shërbime(DNJF).;</li> <li>• Përfaqësues nga OSHC për përfshirjen e tyre në proceset strategjike dhe vendimmarrëse që kërkohen;</li> <li>• Të dhënat statistikore mbi bazën</li> </ul>

	<p>gjinore në lidhje me luftën kundër korrupsionit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërgjegjësimi për të denoncuar korrupsionin duhet të futet në kurrikulat mësimore, në këtë mënyrë për të krijuar një kulturë të përgjithshme të denoncimit.</li> </ul>
--	--

### III. Shortcomings Identified & Preparations for Next Consultation

	Details
(v) Limitations in stakeholder attendance	Po. U ftuan rreth 70 përfaqësues institucionesh, OSHC, akademia, Ministrinë e linjës, në rrugë elektronike (email) dhe thirrje në takimin e parë. Kërkesë të pranishmëve në takimin e parë për të ndarë ftesën për takim me kolegë dhe homologë të tjerë të interesuar.
(vi) Limitations in stakeholder participation	Jo.
(vii) What can be done to improve attendance?	Promovimi në rrjete sociale të angazhimit të Ministrisë së Drejtësisë.
(viii) What can be done to improve participation in the next meeting?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i një ure të përbashkët midis aktorëve të interesuar dhe Ministrisë së Drejtësisë do të ndikojë në ofrimin e propozimeve dhe kontributeve për të përmirësuar secilin nga fushat përkatëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre;</li> <li>• Inkurajim duke biseduar drejtpërdrejt me palët e interesit për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre;</li> </ul>

### Stakeholder Feedback

Name:	Znj. Nysjola Dhoga	Organization/ Affiliation:	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale.	Position:	Pedagoge, Departamenti i Shkencave Politike, UT.

## Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas

### Comments:

- Të dhënat statistikore mbi bazën gjinore në lidhje me luftën kundër korrupsionit, pasi institucionet nuk japin të dhëna mbi përfshirjen e grave në luftën kundër korrupsionit. Gjithashtu edhe sipas rekomandimeve nga Transparency International për integritetin e Shqipërisë që ndahet në 15 shtylla është si kërkesë për institucionet shqiptare të kenë statistika me bazën gjinore.
- Shprehu dakordësi në lidhje me ndërgjegjësimin e publikut të gjerë.
- Ndërgjegjësimi për të denoncuar korrupsionin duhet të futet në kurrikulat mësimore, në këtë mënyrë për të krijuar një kulturë të përgjithshme të denoncimit.

### Issues Raised

### Feedback:

- Nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të integruar në luftën kundër korrupsionit, SNKK do të sigurojë një bashkëpunim më të ngushtë të ekzekutivit me shoqërinë civile dhe sektorin privat për të siguruar mirëqeverisjen dhe integritetin. Politikat strategjike në luftën kundër korrupsionit do të adresojnë çështje dhe rekomadime të cilat janë shënuar në raportet ndërkombëtare në fushën e antikorrupsionit, ndaj dhe për këtë qëllim, project strategjie e re e SNKK, ka të dedikuar një objektiv specifik i cili lidhet me pjesën ndërgjegjesuese të publikut për raportimin e korrupsionit.

<b>Name:</b>	Znj. Aida Zeneli	<b>Organization/ Affiliation:</b>	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile	<b>Position:</b>	Specialiste e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
--------------	------------------	---------------------------------------	---	------------------	--

## Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas

**Comments:**

- Propozoi që të ketë një përfaqësues nga OSHC për përfshirjen e tyre në proceset strategjike dhe vendimmarrëse që kërkohen.

**Issues Raised**

**Feedback:**

- Ministria e Drejtësisë, për dy fushat që ajo mbulon, atë të Politikave në Fushën e Drejtësisë dhe atë të Antikorrupsionit, është një ndër ministrinë që Shoqërinë Civile e ka partner që në fazat e saj të hershme draftimit të dokumentave politik/strategjik.
- Sipas rolit të veprimtarisë së shoqërisë civile, janë anëtare të procesit të monitorimit dhe miratimit të dokumentave politik.



<b>Name:</b>	Z. Milaim Demnushaj	<b>Organization/ Affiliation:</b>	“Të Ndryshëm & Të Barabartë”	<b>Position:</b>	Menaxher	Projekti
<b>Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas</b>						
<p><b>Comments:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rishikimi i ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe disa akteve ligjore në zbatim të tij për të rritur efektivitetin dhe përmirësuar zbatimin e këtij ligji në veçanti për pjesën e garantimit të ndihmës ligjore për kategoritë e veçanta, por edhe çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e sistemit të tërësi, përfshirë edhe angazhimin e OSHQ të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike. Disa çështje që kërkojnë ndryshime ligjore janë: thjeshtimi i procedurave për përfitimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore; autorizimi i OJF edhe ofrimin e ndihmës dytësore; thjeshtimi i procedurës për financimin e shërbimeve; rregullimi i shërbimeve “probono” si mekanizma alternativ për ndihmë juridike falas dhe pa kosto edhe për shtetin; rritja e efektivitetit të ofrimit të ndihmës dytësore nga avokatët e dhomave vendore; shtimi i çështjeve të tjera që rezultojnë me problema nga praktika e deritanishme.</li> <li>- OSHC duhet të mbështeten me fonde shtetërore për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore.</li> <li>- Duhet rritur bashkëpunimi me OSHC që ofrojnë shërbime ligjore për kategoritë në nevojë dhe përmirësohet kuadri ligjor që rregullon rolin e OSHC-ve në këtë fushë.</li> <li>- Duhet zhvilluar fushata ndërgjegjësimi për informimin e shoqërisë dhe në veçanti të grupeve në nevojë të rritur aksesin në drejtësi dhe për ti informuar ata për të drejtat që kanë për ndihmë ligjore falas.</li> <li>- Duhet zhvilluar trajnime me punonjës të administratës në nivel vendor për të rritur kapacitetet e tyre të shërbimit ofrues të ndihmës ligjore por edhe si referues të rasteve me nevoja ligjore.</li> <li>- Duhet përmirësuar sistemi dhe mekanizmat vendor të referimit të rasteve për shërbime ligjore.</li> </ul> <p><b>Issues Raised</b></p>						
<p><b>Feedback:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Propozimet e para të ardhura nga publikimi i pyetësorit është të rrisim informacionin dhe transparencën e publikut se si do përdorim mekanizmat në funksion të aksesit në drejtësi apo të antikorrupsionit.</li> <li>- Ligji për Ndihmën Juridike Falas është përmirësuar ndjeshëm dhe njëkohësisht është bërë punë efektive për të njerëzit në nevojë.</li> <li>- Propozimet do merren në konsideratë në planin e veprimit 2022 – 2024.</li> </ul>						

Në vijim të proceseve të lidhura me Partneritetin për Qeverisjen e Hapur (OGP-Open Government Partnership), "Mbi procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024"; e në në përputhje me planin e punës dhe afateve të vendosura, Amshc-ja filloi punën për planin të veprimit 2022-2024; Kështu AMSHC-ja në kuadër të bashkërendimit të punës së saj me Planin Kombëtar të Veprimit, 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur; për këtë fazë hartoi Pyetësorin tematik për Institucionin ( i cili gjendet i lidhur më me poshtë).

Pyetësori u publikua në faqen zyrtare të Institucionit dhe u shoqërua edhe me një tekst, me të gjitha modalitetet e duhura si dhe afatin kohor brenda të cilit do të duhej të dërgohej

kontributi (afati fundor i mbylljes se marrjes se feedback,dt 18.01.2023); Në të njëjtën kohë pyetësoni tematik iu dërgua gjithashtu për plotësim edhe me email organizatave;

AMSHC-ja duke qenë se është ent publik qendror, buxhetor e ka mardhënien e drejtpërdrejtë me shoqërinë civile; nëpërmjet Mbështetjes Financiare direkte për Shoqërinë Civile në vend, duke dashur të promovojë dhe mbështesë parimet e sundimit të ligjit, dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë, mos-diskriminimit, respektimin e të drejtave të njeriut.

AMSHC-ja gjatë funksionimi te saj në të gjitha Thirrjet për Projekt Propozime duke qenë nëlinjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe ka synuar që prioritetet për Thirrjet për Projekt Propozime; të jenë sa më gjithë përfshirëse, pra që ato të prekin një gamë të gjerë të problematikave që has shoqëria civile.

Saqrojmë se në praktikën e saj të punës AMSHC-ja *Organizon një proces online të hapur konsultativ me shoqërinë civile me qëllim marrjen e feedback-ut mbi përcaktimin e fushave prioritare të thirrjes së radhës duke konsideruar prioritetet e parashikuara me ligj.*

Ne kete llogjike per përcaktimin e fushave prioritare per thirrjet per projekt propozime me qëllimin **per te marr feed-back** nga shoqëria civile, Amshc-ja para cdo thirrje ka organizuar Takime Konsultative me shoqërine civile, për të qenë një instrument lehtësues i dialogut midis shoqërisë civile dhe institucioneve organizatave te cilat jane ne data-basen tone, i cili ka qene online në ëbsite-in tonë: [www.amshc.gov.al](http://www.amshc.gov.al).

Në kuadër të bashkërendimit të punës së AMSHC-së me Planin Kombëtar të Veprimit, 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur; Feedback-u i marr nëpërmjet Pyetësorit tematik të plotësuar online, (rreth 50 organizata të shoqërisë civile) si dhe nga nje pjesë e tyre e shpërndarë në takimin konsultativ të organizuar në dt. 10.01.2023; me tematikën të "Mbi procesin e hartimit te Planit Kombetar te Veprimit per Partneritetin per Qeverisje te Hapur 2022-2024"; (brenda një kohe të shkurtër lajmërimi); është shumë i rëndësishëm dhe për bashkërendimin e punës së AMSHC-së për prioritetet e thirrjes së radhës për Projekt-Propozime;

Feedback-u i marr nëpërmjet Pyetësorit tematik na evidentoi sërish që lufta *Kundër Korrupsionit* si dhe *Edukimi Ligjor* i publikut është ende një prioritet mjaft i rëndësishëm e i prekshëm për shoqërinë civile. Për këtë arsye AMSHC-ja në thirrjet e fundit të saj bazuar në feedback-un e vet shoqërisë civile ka përcaktuar e ka përcaktuar si detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit qe do shpërndahet

Fushat Prioritare të mbledhura nga Feedback-u i marr nëpërmjet Pyetësorit Tematik të sugjeruara nga vet shoqëria civile janë si më poshtë:

Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI (detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit qe do shpërndahet)

- Në fushën e Prokurimeve;
- Në fushën e Arsimit;
- Në fushën e Shëndetësisë dhe
- Zbatimit të Ligjit;
- E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekja e strategjive për përfshirjen e të rinjëve në qeverisje, transparencë e institucioneve publike;
- Edukimi Ligjor i Publikut
- Përfshirja shoqërisë civile në proceset e politik-berjes; per sa i takon reformave publike si dhe vendimarrjeve publike;
- Integrimi europian
- Rritja e rrjetëzimeve te shoqatave te shoqerise civile dhe si dhe rritja e bashkëpunimit te tyre ne kontekstin e përafrimit me Bashkimin Europian;
- Barazia gjinore;
- Lufta kundër diskriminimeve që rrjedhin nga seksi, raca apo bindje të tjera personale;

- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëmi tij;
- Nxitja nismave kulturore dhe artistike brenda/dhe per komunitetet
- Integrimi shoqëror/ekonomik i komunitetit rom si dhe pakicave të tjera të pranishme në Shqipëri;
- Rritja e mbështetjes per personat me aftësi të kufizuara, me fokus shërbimet sociale; etj

### Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacioni/AKSHI (4 angazhime prioritare)

1. Shtimi i të dhënave automatike në portalin e të dhënave të hapura dhe aksesit në Gatishmërinë e të dhënave të hapura (Open Data Readiness).
2. Identifikimi i ngjarjeve proaktive të jetës dhe zbatimi i të paktën 1 ngjarje jetësore (Life Event) në e-Albania në portalin e qeverisë E-Albania.
3. Transpozimi i direktivës së BE-së për aksesueshmërinë në ueb/përportalet qeveritare (Direktiva e aksesueshmërisë në ueb (BE) 2016/2102 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 mbi aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik”).
4. Zhvillimi i mekanizmit të vlerësimit nga ana e qytetarëve për shërbimet elektronike.

## CONSULTATION 1

### Consultation Details

Policy Goal Focus	Angazhime të propozuara  3. Zhvillimi i procesit të digjitalizimit dhe e-qeverisjes 4. Përshtatja e e-albania për personat me aftësi të kufizuara.
Lead Focal Point Institution	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Znj. Romina Kostani/Drejtor, Drejtorja e Inovacionit dhe Promovimit e-Gov</li> </ul>
Date	19.01.2023
Consultation Meeting Number	<b>1</b>

### X. Objective of Consultation Meeting

**What was the aim of this consultation?**  
**Please answer for all that apply**

#### Details:

Takimi u moderua nga **znj.Romina Kostani, Drejtor, Drejtorja e Inovacionit dhe Promovimit e-Gov**, e cila diskutoi në lidhje me arsyen e këtij takimi në kuadër të bashkëhartimit të planit të ri të veprimit për partneritetin për qeverisjen e hapur për periudhën 2022-2024.

	<p>U diskutua në lidhje me Qeverisjen Dixhitale për shërbimet elektronike në portalin e-albania, dhe portalin Open Data për shtimin e të dhënave të hapura nga institucioneve publike Shqiptare. Numri në total i shërbimeve elektronike të ofruara në e-albania për vitin 2022, arriti në 1227 shërbime, 95% e shërbimeve ofrohen online, ndërsa 5% vetëm rastet kur duhen personat fizikisht për të kryer shërbimin.</p> <p>Përsa I përket portalit Open Data, vlerësohet se ka ende vend për të përmirësuar, dhe se është I nevojshëm angazhimi I Shoqërisë Civile, Start Up-ëve, akademikeve, etj që të sugjerojnë se çfarë të dhënash të hapura janë të vlefshme në përdorimin për arsye kërkimore, studimore, për zhvillime aplikacionesh etj.</p> <p>U diskutua në lidhje me Pyetësorin I cili u është dërguar me email dhe duhet plotësuar brenda datës 19 Janar 2023 në kuadër të procesit të bashkëhartimit të planit të ri të veprimit 2022-2024 të OGP.</p>
--	---

<p>(xvii) Introduce stakeholders to the proposed policy goal</p>	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p><b>Open Data:</b> Ky angazhim do të vërë në dispozicion të dhëna të reja nga institucione publike shtesë, si dhe do të zhvillojë strategji për të përmirësuar kuptimin e qytetarëve për përdorimin dhe aplikimin e Portalit të të Dhënave të Hapura dhe për të rritur aksesin për qytetarët.</p> <p><b>Aksesibiliteti:</b> Aktualisht, disa përmirësime teknike janë bërë në faqet e internetit të ministrive, duke u lejuar atyre me aftësi të kufizuara t'i qasen më lehtë. Masat e parashikuara në Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021-2025, lidhen më gjerësisht me përmirësimet në kuadrin ligjor si dhe me përmirësimet teknike, si zhvillimi/përshtatja e standardeve për sigurimin e aksesueshmërisë, për të siguruar që personat me aftësitë e kufizuara kanë akses të barabartë në faqet e internetit të sektorit publik, shërbimet, aplikacionet dhe përmbajtjen e tyre.</p> <p><b>Implementimi i një Life Event:</b> Ngjarjet e jetës janë ngjarje që kanë një ndikim të rëndësishëm në jetën e një qytetari/palësh të interesuar dhe që garantojnë ndërgjegjësimin ose përfshirjen e qeverisë. Shërbimet</p>
--	---

	<p>publike elektronike proaktive do t'u përgjigjen ngjarjeve të jetës që kërkojnë burokraci minimale. Nëpërmjet shërbimeve proaktive dhe të bazuara në ngjarje të jetës, ky angazhim do të ndihmojë shërbimet publike që të kontaktojnë drejtpërdrejt me njerëzit në vend që të presin që ata të vijnë në qeveri.</p> <p><b>Help Desk:</b> Qasja e ridizajnuar HelpDesk do të sigurojë mbështetje shtesë për përdoruesit e shërbimit në aplikacionet e tyre të shërbimit dixhital. Funksione të tjera do të përfshijnë veçoritë e inteligjencës së biznesit dhe monitorimin e performancës së stafit të ndihmës. Ky angazhim do të përmirësojë modelin aktual të zyrës së ndihmës, kujdesin ndaj klientit, aksesueshmërinë, personelin, etj.</p> <p><b>Feedback-u i qytetarëve:</b> Feedback-u i qytetarëve do të mbledhë komentet si dhe do të analizojë automatikisht ato për t'u dhënë anëtarëve të stafit informacion të saktë mbi atë që duhet përmirësuar. Feedback-u i qytetarëve mundëson përfshirje qytetare dhe angazhim më të informuar ndërmjet qeveris dhe qytetarëve. Ai gjithashtu siguron një kuadër të hapur dhe të përgjegjshëm për një vendimmarrje më të mirë dhe rrit besimin e publikut.</p>
(xviii) Introduce stakeholders to the OGP process	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Po. Në Takimin e parë online konsultativ janë ftuar rreth 20 përfaqësues, të organizatave të shoqërisë civile, akademisë, institucioneve publike që kanë veprimtari institucionale të fushës, dhe aktorë të tjerë të interesuar, të cilëve iu dha informacioni i detajuar për procesin e bashkë-hartimit të PKV 2022-2024 të OGP, dhe të parimeve të nismës. Për këtë qëllim u përgatit edhe një material prezantimit PPT, bashkëlidhur këtij raporti.</p>
(xix) Explain the feedback tools for stakeholders	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Në Takimin e parë Konsultativ, i mbajtur Online nëpërmjet platformës Microsoft Teams, Znj. Romina Kostani/Drejtor, Drejtoria e Inovacionit dhe Promovimit e-Gov, dha një prezantim shterues të procesit të OGP, si dhe të detyrimeve dhe angazhimeve konkrete për komponentët respektivë të AKSHI-t.</p> <p>Pjesëmarrësve në takim iu dha mundësia për të pyetur dhe për të komentuar rreth pyetësorit i cili ishte i publikuar më parë online.</p>

	<p>-Pyetësori i hartuar, në kuadër të procesit të bashkë-bërjes së masave prioritare të angazhimeve të Planit Kombëtar të Veprimit, 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (en:OGP), u shpërnda, paraprakisht nëpërmjet emailit dhe u publikua në faqën zyrtare të</p> <p>AKSHI - <a href="https://akshi.gov.al/anketim-me-grupet-e-interesit/">https://akshi.gov.al/anketim-me-grupet-e-interesit/</a></p>
(xx) Brainstorm ideas with stakeholders	<p><input checked="" type="checkbox"/>No / <input type="checkbox"/>Yes</p> <p>Takim konsultativ 1, u ritheksua rëndësia e këtyre angazhimeve edhe nga shoqëria civile si dhe përfshirja e sa më shumë grupeve të interes në përshtatjen e e-albanias për të gjitha grupet e PAK.</p>
(xxi) Develop further details (milestones, etc.) for ideas	<p><input checked="" type="checkbox"/>No / <input type="checkbox"/>Yes</p>
(xxii) Gather feedback on proposed policy goals	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Takimi i parë konsultativ, ishte në format shpjegues për të gjithë aktorët, lidhur me pyetësin e hartuar në bazë të angazhimeve nga AKSHI.</p> <p>Kërkesës së AKSH-it për propozime të reja dhe përfshirjes në angazhime prioritare, në takim pati shumë interes dhe morrëm sygjerime dhe propozime nga OSHC të cilat do të jenë të listuara më poshtë.</p>
(xxiii) Prioritize proposed policy goals	<p><input checked="" type="checkbox"/>No / <input type="checkbox"/>Yes</p>
(xxiv) Other (provide details)	<p><input checked="" type="checkbox"/>No / <input type="checkbox"/>Yes</p>
<b>X. Methodology</b>	
<p><b>What was the format of the meeting?</b> <b>How were stakeholders able to participate?</b></p>	<p>Takimi i parë Konsultativ u organizua Online, i hapur dhe interaktive.</p> <p>Microsoft Teams meeting Meeting ID: 321 919 687 392 Passcode: WEkPCh</p>
(ix) Presentations	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Përfundimi i Planit të Veprimit 2020-2022</li> <li>✓ Prezantimi i komponentëve të realizuar për Planin e Veprimit 2020-2022;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Pyetëtori në lidhje me Planin e Veprimit 2022-2024.</li> <li>✓ Prezantimi i procesit të OGP dhe i komponentëve përbërës të Planit të Veprimit për Qeverisjen e Hapur 2022 - 2024.</li> <li>✓ Kërkesa për pyetje/ndërrhyrje.</li> </ul>
(x) Discussion / Feedback from stakeholders	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Gjatë takimit u dakordësua që çdo propozim i mundshëm të dërgohet elektronikisht në adresat e kontaktit, me qëllim caktimin e angazhimeve prioritare të PKV 2022-2024.
(xi) Questions and answers	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Pjesëmarrësve iu dha mundësia për të bërë pyetje si dhe për të dhënë sygjerimet e tyre përkatëse për këtë angazhim.
(xii) Brainstorming	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Pjesëmarrësve iu dha mundësia për të bërë pyetje dhe diskutuar duke u dhënë dhe disa sygjerime në lidhje me përmisimin në portal.
<b>Stakeholder Selection</b>	<b>Details</b>
(xi) How were stakeholders selected?	Pjesëmarrësit u përzgjedhën në kuadër të bashkëpunimit që ka AKSHI, me OSCH të cilat veprimtaria e tyre ka të bëjë me PKV për 2022-2024. Gjithashtu, pjesëmarrësit u selektuan edhe nga kontaktet dhe eksperiencat e mëparshme të ngjashme, me qëllim gjithëpërfshirjen në këtë proces.
(xii) How were stakeholders contacted?	Palët e interesuara u ftuan të ishin pjesë e këtij procesi në rrugë elektronike dhe telefon. Ftesa u shoqërua edhe me agjendën e takimit, si dhe u njoftuan për plotësimin e pyetësorit dhe mënyrat e aksesimit të tij. Palët e interesuara u njoftuan edhe me publikimin në faqen e AKSHI-t.
(xiii) How many stakeholders were contacted?	(Rreth) 20
(xiv) Was the consultation announced publically? (via websites, social media, etc.)	Po. Procesi i parakonsultimit është njoftuar në faqen zyrtare të AKSH-t dhe OGP Albania. Njoftimi është kryer gjithashtu në rrugë elektronike/via-email dhe telefon.



	<p>Linket e publikimit janë:  <a href="#">Anketim me grupet e interesit – Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (akshi.gov.al)</a>  <a href="https://akshi.gov.al/pyetesor-ogp/">https://akshi.gov.al/pyetesor-ogp/</a></p>
(xv) Were stakeholders reminded?	<p>Po. Palët e interesuara dhe të ftuara në këtë proces janë rikujtuar në rrugë elektronike/ via- e-mail.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Email i parë që përfshin vënien në dijeni për takim: 16/01/2023.</li> <li>• Email i dytë rikujtues që përfshin linkun e pyetësorit: 17/01/2023.</li> <li>• Email i tretë, ku është bashkëngjitur linku i meeting: 18/01/2023.</li> <li>• Email katërt, rikujtesë para fillimit të takimit: 19/01/2023.</li> </ul>
<b>XI. Results/ Findings</b>	
<b>Stakeholder Contributions</b>	<b>Details</b>
(ix) How many stakeholders attended?	6 pjesëmarrës
(x) Did stakeholders contribute?	Po.
(xi) Main issues identified by stakeholders	Takimi ishte konsultativ dhe gjatë takimit palëve prezent iu dhanë këshilla dhe kërkesa për propozime dhe përfshirje në angazhmet e PKV 2022-2024.
(xii) Main recommendations from stakeholders?	Thjeshtimi sa më i madh i portalit në mënyrë që të sjelli aksesueshmërinë sa më të lehtë e të madhe të personave me aftësi të kufizuara.
<b>XII. Shortcomings Identified &amp; Preparations for Next Consultation</b>	
	<b>Details</b>
(ix) Limitations in stakeholder attendance	Jo. U ftuan përfaqësues institucionesh, OSHC, akademia, në rrugë elektronike (email)
(x) Limitations in stakeholder participation	Po. Organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e institucioneve të ftuar në proces ishin 6 nga 19 të ftuar.
(xi) What can be done to improve attendance?	Promovimi në rrjete sociale të angazhimit të AKSHI-t.



(xii) What can be done to improve participation in the next meeting?

- Krijimi i një ure të përbashkët midis aktorëve të interesuar dhe AKSHI-t do të ndikojë në ofrimin e propozimeve dhe kontributeve për të përmirësuar secilin nga fushat përkatëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre;
- Inkurajim duke biseduar drejtpërdrejt me palët e interesit për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre;
- Të ftuarëve dhe pjesëmarrësve iu kërkua plotësimi dhe dërgimi i pyetësorit dhe/apo dhënia e propozimeve në takimin e radhës, të njoftuar për në datë 19.1.2023.

### Stakeholder Feedback

<b>Name:</b>	Znj.Zela Koka	<b>Organization/ Affiliation</b> :	Shoqata MEDPAK	<b>Position:</b> Përfaqësuese	
<b>Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas</b>					
<b>Comments:</b> Znj. Zela sugjeroi thjeshtim sa më të madh të portalit, në mënyre që PAK ta ketë sa më të lehtë aksesimin.					
<b>Issues Raised:</b> -					
<b>Feedback:</b>					
<b>Name:</b>	Znj. Blerta Cani	<b>Organization/ Affiliation</b> :	Fondacionit Shqiptar për PAK	<b>Position:</b> Përfaqësuese	
<b>Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas</b>					

**Comments:**

---

**Issues Raised: -**

---

**Feedback:** vlerësoi nismën dhe tha se është shumë e domosdoshme të merren parasysh krejt nevojat e grupeve të veçanta të PAK. Ajo shprehu gatishmërinë në lidhje me kontributin për bashkëhartimin e akteve ligjore dhe testimin e vazhdueshëm për përmirësimin e portalit në ndihmë të PAK

<b>Name:</b>	Z.Abdulla Omuri	<b>Organization/ Affiliation:</b>	Shoqata e Invalidëve të Punës	<b>Position:</b>	Kryetar
--------------	-----------------	---------------------------------------	-------------------------------	------------------	---------

**Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas**

---

**Comments:** Z. Abdulla u shpreh se është optimist në lidhje me nismën, për lehtësimin që i bëhet kësaj fashe.

---

**Issues Raised: -**

---

**Feedback:** Z. Abdulla shprehu gjithashtu domosdoshmërinë për futjen e kurrikulës të Shërbimeve Online në Arsimin Parauniversitar. Ai tha se vështirësia për PAK është e madhe, dhe se harmonizimi në botën dixhitale çalon, por me projekte të ndryshme lehtësuese, do u vijnë në ndihmë kësaj kategorie në të ardhmen duke e bërë me të lehtë aksesueshmërinë.

<b>Name:</b>	Znj. Nikoleta Spahi	<b>Organizat ion/ Affiliation :</b>	Shoqata e personave që nuk dëgjojnë,	<b>Position:</b>	Përfaqësuese
--------------	---------------------	---	--------------------------------------	------------------	--------------

**Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas**

---

**Comments:**

---

**Issues Raised: -**

---

**Feedback:** Znj. Nikoleta sugjeroi që shërbimet të jenë të shoqëruara me video në gjuhën shqipe, manuale përdorimi nëpërmjet interpretimit të shenjave.

**STAKEHOLDER ATTENDANCE**

## **Ministri i Shtetit per Sipermarrje (5 angazhime prioritare)**

1. Promovomimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen.
2. Shqyrtimi, ndjekja dhe trajtimi i ankesave administrative të sipërmarrjeve private, përfshirë ato të investitorëve strategjikë dhe/ose të huaj, kundrejt institucioneve publike, të cilat përfshijnë institucionet publike të pushtetit qendror, vendor, shoqërive publike si dhe të zyrtarëve të tyre.
3. Përpunimi dhe propozimi i përmirësimeve të nevojshme funksionale, për platformën elektronike të ndërveprimit me sipërmarrjen për komunikimin dhe gjurmimin e ankesave të tyre, si dhe për regjistrin e komunikimit të brendshëm të trajtimit të ankesave, përmes të cilit monitoron procesin ndërinstitucional.
4. Promovimi i transparencës dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike.
5. Angazhimi i Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në monitorimin e indikatorëve sasiorë dhe cilësorë të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen si dhe propozimi i mekanizmave institucionale/ndërinstitucionale në funksion të raporteve ndërkombëtare që lidhen me sipërmarrjen, është gjithashtu themelor për përmbushjen e misionit të tij.

### **Takim me OSHC-të për konsultimin e prioriteteve në kuadër të inicimit të procesit të PKV 2022-2024**

Takimi u zhvillua online në platformën Teams më datë 18 Janar 2023, nga ora 11:00 deri në orën 13:00.

Në takim morën pjesë 58 përfaqësues të ekosistemit, të cilët u informuan mbi arsyen e takimit, u ndërgjegjësuam mbi pyetësonin dhe qëllimin e nismës dhe dhanë opinionet e tyre të cilat janë zbardhur dhe më poshtë.

### ***Rezultate lidhur me pyetësonin tematik (përmbledhje informative mbi rezultatet e pyetësonit)***

Me datë 10.01.2023 u përgatit pyetësoni tematik, sipas fushave të përgjegjësisë të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në përputhje me parimet e OGP – së përmes të cilit identifikohen fushat prioritare të MiSHMS.

Ky pyetëson u publikua në faqen e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, si dhe u shpërnda në çdo mënyrë zyrtare tek organizatat, grupet e interesit me të cilët ministria bashkëpunon.

<https://sipermarrja.gov.al/publikohet-pyetesori-per-bashke-berjen-e-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur/>

Publikimi u shoqërua me adresën e kontaktit ku do të dërgohet pyetësoni si dhe afatin brenda të cilit do të dërgohet kontributi (feedback).

Bashkëpunëtorët u treguan të gatshëm të japin kontributin e tyre në plotësimin e pyetësonit brenda afatit të përcaktuar.

1. **Propozimi 1:** Mbështetja dhe zhvillimi i startup – eve nëpërmjet ligjit të startup - eve
2. **Propozimi 2:** Përmirësimi i klimës së investimeve në vend, nëpërmjet ligjit të dhomave të tregtisë dhe industrisë

të anketuarit ju përgjigjen:

- 100 % e të anketuarëve janë dakort me mbështetjen dhe zhvillimin e startup – eve nëpërmjet ligjit të startup – eve.

Ndërsa në lidhje me propozimin 2:

- 60% e tyre janë dakort;
- 20% janë pjesërisht dakort
- 20 % nuk janë dakort sepse ata mendojnë se krahas Dhomave të Tregtisë sot ka aktorë të rinj që kryejnë investime, siç janë Shoqatat e prodhuesve, Agjencitë e Zhvillimit Ekonomik Lokal, Sipërmarrjet Sociale. Gjithashtu edhe Ligji i Investimeve duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të integrojë kontributin në investime të të gjithë aktorëve të rinj.

**Disa nga propozimet e tyre për vendosjen e një angazhimi të ri në përmirësimin e klimës së investimeve në vend:**

1. Përmirësimi i klimës së investimeve nëvend përmes rritjes së transparencës në Platformën e OGP-së.
2. Për produktet organike ose produktet BIO me impakt 0 në ambient dhe ndërmarrjet që ndjekin udhëzimet ndërkombëtare në respekt të mjedisit dhe me ndotje 0, duhet patjetër parashikuar një angazhim më serioz në OGP 2022-2024 që të jetë i dukshëm me kontribut konkret në formë financiare ose në mbështetje dhe mbrojtje në treg etj.
3. Për një vendosje të re në klimën e investimeve mund të ndihmohet me anë të bashkëpunimeve dhe partnerëve të jashtëm por edhe të brendshëm në angazhimin e tyre në vendin tonë.
4. Duhet rishqyrtuar mënyra e krijimit të një biznesi.
5. Rritja e sigurisë së të dhënave si angazhim i komponentit “Qeverisja Dixhitale”. Zhvillimi i trajnimeve në fushën e cybersecurity për punonjësit e administratës dhe qytetarët. Krijimi i sistemeve të administratës publike të bazuara në Blockchain për të shmangur hackimet e tyre nga grupe keqdashësish.
6. Promovimi i sipërmarrësve jashtë vendit që janë me origjinë shqiptare si ambasador të vendit, si dhe të promovohen të rinjtë që punojnë në sipërmarrje të mëdha.
7. Ndërtimi i mekanizmave që garantojnë dhe promovojnë transparencën e kompanive ekzistuese dhe të reja, me synim rritjen e interesit për investime.
8. Shfrytëzimin e teknologjive të reja për forcimin e qeverisjes.
9. Krijimi i faciliteteve fiskale gjatë viteve të para të funksionimit të një veprimtarie. Nga ana tjetër edhe konsulencat që qartësojnë rrugëtimin ligjor për formalizimin e një investimi do të kishin efekt pozitiv në ndërrmarjen e iniciativave të reja të biznesit.

**Disa nga propozimet e tyre për vendosjen e një angazhimi të ri në fushën e startup – eve dhe inovacionit**

1. Platforma OGP (Open Government Partnership) mund të përfshijë rubrikë të dedikuara për startup-et informacion për akses në financë, suport përmes kredive bankare me linja të dedikuara dhe fond garancie në dispozicion të startup-eve.
2. Fusha e TIK.
3. Vendosja e rregullave të rakorduara me legjislacionin në fuqi nga ku mund të bëhet akoma më mirë që një startup - i ri të ketë mundësi dhe të zhvillohet sa më mirë në biznes.
4. Krijimi i platformave crowdfunding që të kenë një impakt direkt mbi kërkesën e njerëzve të cilët do ta financojnë.
5. Rritja e numrit të thirrjeve për kategori të ndryshme startup-esh dhe rritja e numrit të fituesve të këtyre thirrjeve. Të rritet transparenca e fituesve të thirrjeve dhe të krijohet hapësirë dhe mundësi edhe për startup-et dhe organizatat e reja.
6. Të ketë një portal për të gjitha aktivitetet e përbashkëta në të mirë të Sipërmarrjes që drejtojnë të gjithë akseleratorët, inkubatorët apo startupet si marrëveshje të tyre me Ministrinë e Sipërmarrjes ku të kontrollohet nga ministria dhe të nxjerrin statistika nga datat e mbledhura që mund të kuptohet target grupi apo nevojat nga momenti i përdorimit.
7. Mbështetja e vazhdueshme dhe në rritje, kryesisht e startupeve që zgjidhin përmes teknologjisë probleme në sektorë kyç si financat dhe bank-ingu, turizmi, bujqësia, edukimi dhe shëndetësia, mjedisi si dhe shfaqin potencialin për rritje në tregun lokal dhe atë ndërkombëtar.
8. Suportimi me mentorim ndërkombëtar nga vende të zhvilluara në fushën e start-up dhe teknologjisë.
9. Zhvillimi i trajnimeve që informojnë të rinjtë me aspektet e tjera të nevojshme për hapjen e bizneseve. Rritja e financimeve nga ana e buxhetit të shtetit për këto startup-e.

100 % e të anketuarëve shprehen se janë të përfshirë në nismat dhe iniciativat që informojnë për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve.

Një sugjerim që ato japin është që *“Programet Europiane për zhvillimin e startup-eve duhet të publikohen në mënyrë të vazhdueshme për të rritur aksesin e startup-eve për fonde”*.

Në lidhje me përfshirjen në nismat dhe iniciativat që informojnë në përmirësimin e klimës së investimeve në vend vetëm një numër i vogël i tyre shprehen se janë të përfshirë.

Angazhimet kryesore që ata do të donin të përfshihen në Planin OGP 2022-2024 në kuadër të përmirësimit të klimës së investimeve në vend janë:

- Duhet të mbahet në konsideratë dhe që është pjesë e komponentit “Qeverisja Dixhitale” është përmirësimi dhe rritja e sigurisë së sistemeve të administratës publike dhe e-albania.
- Krijimi dhe forcimi i partneriteteve me kompani prestigjioze ndërkombëtare.
- Promovim më të lartë të Shqipërisë jashtë vendit, promovim nëpërmjet rasteve të suksesit, fushata të vazhdueshme promovuese, funksionimi eficient i agjencisë së investimeve të huaja AIDA.
- Rritjen e transparencës, raportimit qeveritar dhe përmirësimin në aksesueshmërinë në informacionit; Modernizimin e shërbimeve publike në aspektin teknologji.

Pjesa më e madhe e të anketuarëve kanë marrë pjesë në sesionet e informimit për mbështetjen e startup-eve. Ata gjithashtu sugjerojnë *“Promovimin e praktikave të mira, ndarja e eksperiencave pozitive me startup-et e reja për të rritur motivimin dhe inspirimin.”*

*Marrëveshje me Universitetet që ato të krijojnë zyrat për nxitjen dhe krijimin e startup-eve dhe t'i përfshijnë në Planet Strategjike të Zhvillimit të Tyre”.*

Një pjesëe vogël e tyre shprehen se kanë marrë pjesë në aktivitete ose takime ndërmjet dhomave të tregtisë në vend.

Sipas tyre njëOSHC dhe/apo grup i interesuar mund të kontribuojë në propozimet që kanë dhënë nëpërmjet:

1. Dhënia vetëm e idesë së propozimit
2. Implementimi
3. Ndërgjegjësimi
4. Financimi i një aktiviteti/iniciative konkrete

### **Ministria e Shëndetësisë (3 angazhime prioritare)**

1. Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut e në mënyrë të veçantë grupeve në nevojë lidhur me aksesin në shërbimet gjithëpërfshirëse.
2. Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve, me përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve për kategoritë më vulnerabël si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGRBTI, të moshuarit.
3. Forcimi i bashkëpunimit dhe mekanizmave monitorues me aktorët e shoqërisë civile me përparësi ndaj grupeve të veçanta;

Në kuadër të zbatimit të kalendarit teknik metodologjik të procesit për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur 2022-2024, ju informojmë si vijon:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i konsideron organizatat e shoqërisë civile (OSHC) si aktorë të rëndësishëm në konsolidimin e qeverisjes së mirë dhe transparencës. MSHMSka bashkëpunim në vijimësi dhe konsulton me OSHC-të dokumentat strategjike, planet e veprimit, aktet ligjore dhe nënligjore, për të dy fushat e përgjegjësisë së MSHMS-së, shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale.

Në Këshillat Kombëtarë që drejtohen nga MSHMS, organizatat e shoqërisë civile përfaqësohen me anëtarësi në: Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile; Barazinë Gjinore; Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve; Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë për Personat me Aftësi të Kufizuar, sipas përcaktimeve ligjore respektive.

Gjatë periudhës Dhjetor 2022 -20 Janar 2023, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka vijuar me proceset e bashkëbërjes së Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur 2022-2024, sipas afateve të përcaktuara në kalendarin teknik duke ndjekur procedurat dhe metodologjinë e dërguar nga institucioni Juaj, nëpërmjet konsultimeve e diskutimeve me organizatat e shoqërisë civile.

Fillimisht u përgatit një pyetësor tematik sipas fushave të përgjegjësisë së institucionit tonë, në përputhje me parimet e Partneritetit dhe Qeverisjessë Hapur, përmes të cilit identifikohen fushat prioritare, angazhimet dhe masat prioritare.

Pyetësori tematik, afati i plotësimit të të cilit ishte data 18.01.2023, ju shpërnda përmes e-maileve të gjitha organizatave të shoqërisë civile me të cilat ne bashkëpunojmë, si dhe u publikua në faqen zyrtare të MSHMS-së në linkun: (<https://shendetesia.gov.al/publikohet->

Në datën 19/1/2023, në mjediset e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u zhvillua një takim konsultues me përfaqësues nga OSHC-të, që punojnë në fushat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të organizatave të grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, etj.

Synimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi draft-propozimet prioritare që ishin përfshirë në pyetësin tematik, marrja e sugjerimeve apo propozime të reja direkt nga përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile.

Propozimet kishin si qëllim forcimin e kuadrit informues, monitorues, përmes instrumentave dhe mekanizmave transparentë bashkëpunim me shoqërinë civile, duke lehtësuar qasjen gjithëpërfshirëse në shërbimet publike dhe shërbimet që ofrohen për grupe të disavantazuara.

### **Informacion mbi gjetjet e Pyetësit për OSHC përfaqësues të kategorive të vecanta si dhe publikut të gjerë publikuar në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kuadër të procesit të bashkë-bërjes të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024, me qëllim konsultimin me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, (OSHC), publikoi pyetësin përkatës dhe janë marrë kontributet si vijon nga OSHC:

- World Vision,
- Observatori për Fëmijët
- ANAD,
- Të ndryshëm të Barabartë,
- Save the Children
- Qendra për Zhvillimin Komunitar “Sot për të ardhmen”
- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Përsa u përket dy propozimeve (**Pyetja 1**) për Angazhime për Planin Kombëtar të Veprimit 2022-2024 të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024, të gjitha OSHC që kanë komentuar janë shprehur dakord me propozimet si vijon:

- Propozimi 1: Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut mbi aksesin në shërbime sociale gjithëpërfshirëse
- Propozimi 2 Forcimi i bashkëpunimit dhe mekanizmave monitorues me aktorët e institucioneve dhe shoqërisë civile me përparësi ndaj grupeve të vecanta.

Lidhur me propozime të reja (**Pyetja 2**) një tematikë e re është propozuar nga OSHC “Të ndryshëm të barabartë” konkretisht “Krijimi i mekanizmave për përfshirjen direkte të grupeve në nevojë në procesin e hartimit të politikave dhe programeve të lidhura me shërbimet dhe mbrojtjen e tyre si përfitues

Lidhur me **pyetjen 3** World Vision komenton se janë të informuar dhe përditësuar për politika sociale të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me fëmijët, pasi jemi pjesë e proceseve të vazhdueshme konsultuese si dhe sugjerojnë se Informimi dhe edukimi i fëmijëve dhe të rinjve për mekanizmat e kontrollit komunitar të buxhetimit, por edhe shpenzimit të buxhetit nga qeverisja lokale e qendrore.

Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi i grupeve vulnerabël lidhur me rolin e tyre për të



nxitur transparencën, anti-korrupsionin dhe llogaridhënien në qeverisje si dhe aftësimi i grupeve vulnerabël për përmirësimin e përdorimit të mekanizmave ekzistues, të cilat kontribuojnë në transparencën dhe eficientësinë e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit p.sh nëpërmjet e-government mekanizmave të ankesave etj.

Lidhur me tematika dhe sesione informimi dhe trajnimi (**pyetja 4**), OSHC janë

- Informim me transparencë mbi legjislacionin dhe shërbimet për grupet në nevojë
- Buxhetim me transparencë
- Shtrirja e shërbimeve në të gjithë territorin;
- Rritja e ndërgjegjësimit, dhënia e informacionit për shërbimet ekzistuese;
- Sistem efektiv referimi që adreson nevojat e çdo individit në nevojë;
- Rritja e kapaciteteve dhe e profesionalizmit të profesionistëve me përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve për këto kategori;
- Stigmatizimi dhe diskriminimi; etj.

Pyetja 5 Lidhur me sfidën për qeverisjen e hapur OSHC (Pyetja Nr. 5) sfidat aktuale për të gjitha grupet e përmendura, OSHC kanë fokus grupet që ato advokojnë brenda fushave të përmendura Barazinë gjinore apo përfaqësimin gjinor/Fëmijët dhe adoleshentët/Romët dhe Egjiptianët/Personat me Aftësi të Kufizuara/Të moshuarit.

Përsa i përket kontributit të OSHC në vazhdimësinë e planit (Pyetja 6) OSHC. Të gjitha OSHC mund të kontribuojnë në Implementim, ndërgjegjësim dhe financimi i një aktiviteti/iniciative konkrete japin kontribut nëpërmjet projekteve që zbatohen në fusha të ndryshme dhe shprehin gadishmërinë të ofrojnë kontribut në aktivitete dhe fusha të tjera të lidhura me angazhime që mund të krijohen në kuadër të të Planit Kombëtar të Veprimit, 2022-2024 të Partneritetit për Qeverisje të Hapur. Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” (D&E) mund të kontribuojnë në aktivitete në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit përfshirë, viktimat e dhunës në familje dhe me bazë gjinore, viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, viktimat e abuzimit seksual, fëmijet e tyre dhe grupe të tjera në nevojë me shërbime të integruara dhe mbrojtje të grupeve në nevojë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kuadër të procesit të bashkë-bërjes të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024, realizoi konsultimin e parë në bashkëpunim me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, (OSHC).

Ky takim u zhvillua në datë 19 Janar 2023, në sallën e mbledhjeve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

### **Qëllimi i takimit:**

Prezantimi i bashkë-bërjes së procesit të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024, me synim vendosjen e prioritetëve për periudhën dy-vjecare në vazhdim.

- ✓ Fillimisht u prezantua qëllimi i hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024, si dhe rolin e OSHC-ve në këtë proces.
- ✓ MSHMS në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur prej vitesh ka një bashkëpunim shumë të mirë me rrjetin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC), në përfaqësim të drejtpërdrejtë përmes Këshillave Kombëtare (Barazinë Gjinore, PAK, Fëmijët).
- ✓ Procesi i bashkë-bërjes të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024, fokusohet në kontributet tuaja të dhëna nëpërmjet pyetësorëve të shpërndarë në adresën elektronike të MSHMS;
- ✓ Procesi i mbarëvajtjes së hartimit të këtij Plani kërkon të tërheqë mendime, ide nga të gjithë aktorët e shoqërisë civile, të cilët do të ndikojnë më pas në përgatitjen cilësore të projekt ligjeve apodraft-strategjive në fushën e kujdesit dhe mbrojtjes sociale për të gjithë grupet sociale.
- ✓ Përmes procesit të bashkë-bërjes në hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024, organizatave të shoqërisë civile do t'u krijohet mundësia epërfshirjes aktive .

Më pas u kalua në diskutime dhe sugjerime nga përfaqësuesit e OSHC-ve.

Përfaqësuesit e njohur më parë me pyetësorin e draft-propozimeve të shpërndara edhe përmes e-maileve dhe të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë, në përgjithësi u shprehën të dakortësuar me propozimet, duke theksuar se e vlerësojnë shumë bashkëpunimin me MSHMS përgjatë gjithë konsultimeve të akteve ligjore, të strategjive dhe planeve të veprimit për përfshirjen e grupeve në nevojë në kuadër dhe të transparencës dhe të gjithëpërfshirjes.

OSHC-të kërkuar që në kuadër të bashkë-bërjes të bëhet edhe përditësimi i hartës së shërbimeve sociale të të gjithë organizatave që punojnë në mbështetje dhe favor të grupeve sociale, me një adresar të përditësuar të organizatave, me synim dhe të njohjes së eksperizës më të mirë midis tyre në ofrimin e shërbimeve,;

Gjithashtu kërkuar që nga ana e MSHMS-së të mundësohet krijimi i një rrjetëzimi të organizatave si dhe fuqizimi i kapaciteteve të tyre.

Në mbyllje të takimit lidhur me çështjet e diskutuara dhe parashtruara në takimin konsultues u ra parimisht dakort për:

- Forcimine bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile (OSHC), me synim mbështetjeje të procesit të bashkë-bërjes së hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024.
- Fuqizimine kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile në vazhdim,
- Përditësimin dhe ndarjen së eksperiencave më të mira
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i grupeve në nevojë lidhur me aksesin në shërbimet gjithëpërfshirëse.

## **Ministria e Arsimit (2 angazhime prioritare)**

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë për rëndësinë e gjithëpërfshirjes në arsim.
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi ndikimin e digjitalizimit të sistemit arsimor për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuar në krijimin e një shoqërie bazuar në dije.

Në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritet & Qeverisje të Hapur 2022-2024, Ministria e Arsimit dhe Sportit sipas kalendarit Teknik Metodologjik të procesit të hartimit të këtij plani organizoi dy takime me organizata të ndryshme të shoqërisë civile OSHC, të cilat kanë në fokus të veprimtarisë së tyre çështjet lidhur me arsimin dhe me fushën e përgjegjësisë së MAS. Këto takime u organizuan në mënyrë hibride, pra takimi i parë online dhe takimi i dytë në ambjentet e Ministrisë së Arsimit si më poshtë vijon:

### **Takimi I: datë 16.01.2023**

### **Takimi II: datë 20.01.2023**

Në dy takimet e organizuara me grupet e interesit për të diskutuar, konsultuar dhe bashkë-ndarë listën prioritare me idetë lidhur me fushat e angazhimit të MAS morën pjesë: Child Rights Centre Albania (CRCA), Komiteti për Pakicat Kombëtare, IRCA, Terre des Hommes, Organizata “Fëmijët Janë e Ardhmja”, Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Institute for Democracy and Communication (IDM), Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve”, Komiteti për Pakicat Kombëtare, Roma Active Albania, Gruaje Rome, Drejtësi Sociale, Koalicioni i Arsimit, Save the Children, UNICEF, World Vision, Kongresi Rinor Kombëtar, Junior Achievement of Albania, MEDPAK, Qendra për Arsim Cilësor, Shkolla e Drejtorëve, Ambasada Italiane, Autizmi Flet (Club Kombëtar i Prindërve të Fëmijëve me ÇSA&PAK), Bashki të Forta, ANAD dhe Këshilli i Evropës.

Pjesëmarrësve u dërgua paraprakisht me email pyetësi-sondazh me prioritetet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për të evidentuar/shtuar masa të tjera specifike të cila këto organizata mund t'i hasin në përditshmërinë e veprimtarive të tyre.

<https://arsimi.gov.al/pyetesori-per-bashke-berjen-e-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur/>

### **Pyetësor në kuadër të procesit të bashkë-bërjes së masave prioritare të angazhimeve të Planit Kombëtar të Veprimit, 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (en:OGP)**

Për plotësim nga institucionet publike, OSHC-të, grupet e interesit/të rinjtë dhe publiku i gjerë

Afati për dërgim kontributi të kërkuar dhe propozimesh: 19 janar 2023

### **Rezultatet e sondazhit me Propozimet e ardhura nga grupet e interesit:**

- Dakordësi mbi listën e angazhimeve prioritare të MAS;

- Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të angazhohet në promovimin e arsimit gjithëpërfshirës specifikisht për nxënësit që nuk dëgjojnë, nëpërmjet trajnimit në gjuhën e shenjave të mësuesve dhe ndihmës mësuesve të cilët punojnë me nxënësit që nuk dëgjojnë;
- Ministria duhet të përfshijë konceptin e edukimit dygjuhësor si një nga mënyrat e vetme të edukimit të nxënësve që nuk dëgjojnë në strategjitë e arsimit dhe cdo dokument i cili promovon identitetin gjuhësor të nxënësve që nuk dëgjojnë;
- Digjitalizimi është shumë i rëndësishëm për nxënësit që nuk dëgjojnë, kjo nënkupton zhvillimin e mësimin nëpërmjet platformave E-Learning të orientuara drejt edukimit dygjuhësor;
- Angazhimi i ri i qeverisë duhet të jetë ndërtimi i platformave E-learning të aksesueshme në gjuhën e shenjave dhe në gjuhën. e shkruar për nxënësit që nuk dëgjojnë;
- ANAD gjykon se është shumë e rëndësishme të kujdesemi për informimin dhe ndërgjegjësimin e prindërve të fëmijëve që nuk dëgjojnë lidhur me rëndësinë që ka edukimi i fëmijëve të tyre në gjuhën e shenjave;
- Ministria duhet të angazhohet në fushata ndërgjegjësuese për prindërit dhe të gjithë mësuesit rreth rëndësisë së edukimit të fëmijëve që nuk dëgjojnë nëpërmjet dygjuhësive e cila siguron gjithëpërfshirje në shoqëri;
- Angazhimi shumëpalësh dhe ndërinstucional për transformimin e arsimit dhe transferimin e njohurive dhe dijeve lidhur me tregun e punës;
- Sigurimi i infrastruktures dhe aksesit në pajisjet dhe platformat digjitale në mënyre horizontale në të gjithë shkollat e vendit, dhe rritja e kapaciteteve të mësuesve për përdorimin efektiv të tyre pazgjitshmerisht me metodat tradicionale të mesimdhënisë;
- Promovimi i Kompetencave për Kulturë Demokratike;
- Promovimi i Kompetencave për Qytetari Digjitale;
- Trajnimi i mësuesëve për metodat e mësim dhënisë në klasat gjithëpërfshirëse, duke u bazuar në “Dizenjimin universal të të nxënës”;;
- Trajnimi i Ekipeve multidisiplinore në ZVAP dhe institucionet arsimore, për vlerësimin bio-psiko-social dhe lidhja e punës me komisionin bio-psiko-social në bashki për të dhënë një arsim cilësor për të gjithë fëmijët.
- Rritja e kapaciteteve të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si të ndihmojnë fëmijën e tyre për arritjen e aftësive akademike në kohën e shkollimit, duke filluar që nga mosha 3 vjeç
- Krijimi hapësirave zhvillimore në çdo shkollë dhe trajnimi i gjithë mësuesve të shkolles si duhen dhe pse janë hapësirat zhvillimore. Mos të ngelen hapësira vetëm për mësuesin ndihmës dhe nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Cdo shkollë ta mendojë vetë përse i duhet hapësira zhvillimore, sipas vlerësimit të zonës ku është shkolla, bazuar në kulturën e atij komunitetit.
- Zgjatja e orarit të qëndrimit të fëmijëve në shkollë duke pilotuar në disa shkolla që kanë kapacitete ( hapësira dhe kushtë për krijimin e mësuesve). Le të fillohet fillimisht në shkollat që janë përfshirë në programin “Shkolla për shëndetin ” nga Save the Children.
- Ndërgjegjësim i mësuesëve për ta parë cdo ndryshim në klasën e tyre si vlerë të shtuar.
- Ndërgjegjësim i komuniteteve shkollore prindër, nxënës, anëtarë të komunitetit që gjithëpërfshirja do të arrihet kur komuniteti të ndryshojë kulturën e vet për të pranuar çdo ndryshim.

- Vlerësimi i aftësive të fëmijëve me aftësi të kufizuara, bazuar në aftësitë e prindërve dhe këshillimi i prindërve për të orientuar drejt një karriere për të bërë jetesë të pavarur në të ardhmen.
- Ofrimi i ndihmës teknike për mësuesit dhe profesionistët e edukimit lidhur me gjithëpërfshirjen e nxënësve në mësimin online dhe sidomos asistimin online gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Rritja e ndërgjegjësimit të profesionistëve dhe aktorëve përkatës për rëndësinë e krijimit të një mjedisi të sigurt e gjithëpërfshirës në shkolla.
- Ofrimi i ndihmës (teknike) për mësuesit dhe profesionistët e edukimit lidhur me mësimin online
- Zhvillimi i një sistemi online për raportimin dhe vlerësimin e shkeljeve të etikës profesionale dhe cënimit të të drejtave të fëmijëve në mjediset shkollore.
- Të bëhen të detyrueshme të dyja gjuhët e huaja në shkollë;
- Këshillohet që projekti pilot Antikorrupsion që po zhvillohet me MD, të zbatohet në gjithë vendin dhe në më tepër shkolla

### **Ministria e Financave (3 angazhime prioritare)**

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën buxhetore
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën e tëardhurave
3. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi financat publike

### **Takime konsultuese mbi hartimin e Planit të Veprimit të OGP 2022-2024**

Me 12 janar 2023, ora 14.00, u organizua takimi konsultues me Organizatat e Shoqërisë Civile. Qëllimi i takimit ishte njoftimi i përfaqësuesve të grupit të interesit dhe Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) për fillimin e procesit të hartimit të Planit të Veprimit 2022-2024 për Partneritetin për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership – OGP), prezantimi i metodologjisë për hartimin e planit të veprimit dhe ftesa për OSHC-të për bashkë-bërjen e Planit të Veprimit 2022-2024 duke përcjellë prioritetet/ide/angazhime për tu bërë pjesë e këtij plani veprimi.

Me 17 janar 2023, ora 10.00, u organizua takimi i dytë konsultues me Organizatat e Shoqërisë Civile në kuadër të hartimit të Planit të Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership-OGP) 2022-2024. Qëllimi i takimit ishte diskutimi mbi prioritetet dhe angazhimet që përfaqësuesit e OSHC-ve dhe grupeve të interesit sugjerojnë të bëhen pjesë e Planit të Veprimit 2022-2024 të OGP-së si edhe adresimi i tyre te institucionet përgjegjëse respektive.

### **Rezultate mbi Pyetësorët në kuadër të procesit të bashkë-bërjes së masave prioritare të angazhimeve të Planit Kombëtar të Veprimit, 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur**

Pas marrjes së njoftimit për fillimin e procesit për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në datën 09.12.2022, është mbledhur grupi i punës i cili përbëhet nga Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, Drejtoria e Procesimit të Biznesit, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit dhe Drejtoria e Menaxhimit të Reformës së Financave Publike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Qëllimi i takimit ishte për të shpjeguar procesin e hartimit të Planit të Veprimit të OGP 2022-2024 dhe për të përcjellë propozimet për vitin 2023 dhe

45 Përsa i përket kontributit të OSHC në vazhdimësinë e planit (Pyetja 6) OSHC. Të gjitha Oshc mund të kontribuojnë në Implementim, ndërgjegjësim dhe financimi i një aktiviteti/iniciative konkrete japin kontribut nëpërmjet projekteve që zbatohen në fusha t | Co-Creation Feedback Report

2024. Për këtë qëllim, në datën 13.12.2022 u zhvillua një takim dhe me Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit. Janë koordinuar, mbledhur dhe diskutuar kontributet nga secila drejtori dhe u propozuan dy angazhime kryesore për tu përfshirë më planin e veprimit 2022-2024: 1) Transparenca në Buxhet; 2) Transparenca e të ardhurave.

Një element shumë i rëndësishëm në këtë proces është bashkë-hartimi i planit të veprimit 2022-2024 me grupet e interesit / Organizatat e Shoqërisë Civile dhe përfshirja e angazhimeve të propozuara nga ana e tyre. Për këtë qëllim u përgatit pyetësori për marrjen e mendimit nga publiku i gjerë për përcjelljen e propozimeve. Pyetësori u përcoll elektronikisht në datën 10 janar 2023, tek 56 Organizata të Shoqërisë Civile dhe grupe të tjera të interesit. Gjithashtu, pyetësori është publikuar në websit-in e MFE url: <https://financa.gov.al/shpallje-njoftimesh/> dhe është përcjellë për publikim dhe në faqen zyrtare të OGP Albania. Afati për dërgimin e kontributeve ishte data 18 janar 2023, në adresën [pfm.unit@financa.gov.al](mailto:pfm.unit@financa.gov.al).

Përsa më sipër dhe me qëllim angazhimit të OSHC-ve u organizuan dy takime konsultuese. Takimi i parë konsultues u zhvillua në datën 12 janar 2023, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me qëllim njoftimin e përfaqësuesve të grupit të interesit dhe OSHC-ve për fillimin e procesit të hartimit të Planit të Veprimit 2022-2024 për OGP dhe ftesën për OSHC-të për bashkë-bërjen e Planit të Veprimit 2022-2024 duke përcjellë prioritetet/ide/angazhime për tu bërë pjesë e këtij plani veprimi. Takimi i dytë konsultues u zhvillua në datën 17 janar, online në platformën Teams. Qëllimi i takimit ishte diskutimi mbi prioritetet dhe angazhimet që përfaqësuesit e OSHC-ve dhe grupeve të interesit sugjerojnë të bëhen pjesë e Planit të Veprimit 2022-2024 të OGP-së si edhe adresimi i tyre te institucionet përgjegjëse respektive.

Pyetësori u plotësua nga 4 Organizata të Shoqërisë Civile, konkretisht nga ‘Albanian Initiative for Development’, ‘Instituti i Politikave të Qëndrueshme’, ‘Sustainable Finance and Innovation Centre’ dhe ‘Save the Children’.

#### **Masat e propozuara nga Drejtori në MFE janë:**

**Për angazhimin: “Transparenca e Buxhetit”,** nga Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit u propozuan masat si në vijim:

- **Forcimi i mbikëqyrjes financiare dhe menaxhimit të risqeve fiskale në mënyrë që të kemi një DRF të përmirësuar me më shumë risqe fiskale të monitoruara dhe të zbutura nëse është e nevojshme**
- **Monitorimi i procesit të zbatimit të buxhetit sipas treguesve kryesorë të performancës (KPI)**

Nga Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor u propozuan masat si në vijim:

- **OSHC-të / OJQ-të Seancat dëgjimore të PBA-së**

**Për angazhimin: “Transparenca e të ardhurave”,** nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit u propozuan masat si në vijim:

- **Miratimi i akteve ligjore dhe standardeve të kontabilitetit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP).**
- **Përgatitja dhe zbatimi i metodologjisë për inventarizimin dhe vlerësimin e aseteve të sektorit publik**



Nga *Drejtoria e Procesimit të Biznesit* u propozuan masat si në vijim:

- **Inventari i plotë i asetëve publike regjistrohet në Sistemin e Informacionit Financiar të Qeverisë Shqiptare (AGFIS) nga ato Institucione Buxhetore (IB) që kanë akses të drejtpërdrejtë në sistem.**
- **Inventari i plotë i asetëve publike regjistrohet në Excel për Institucionet Buxhetore (BI) të cilat nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në AGFIS**

**Masat prioritare / angazhimet e propozuara nga OSHC-të për tu përfshirë në planin e Veprimit 2022-2024:**

### **Albanian Initiative for Development**

- Prioritete / angazhime për tu përfshirë në Planin e Veprimit 2022-2024 për OGP paraqitet si mëposhtë:

Është e rëndësishme të forcohet më tej pjesëmarrja e publikut dhe të ofrohen mundësi formale për publikun që të angazhohet në të gjitha fazat e përgatitjes së buxhetit (planifikimi, ekzekutimi, monitorimi). Në mënyrë që të nxitet dhe të promovohet transparenca fiskale në publik, “*Albanian Initiative for Development*”, **propozon që masat e mëposhtme të jenë pjesë e Planit të Veprimit të OGP 2022-2024:**

- **krijimi i platformave të komunikimit për të ndihmuar qytetarët, studentët, akademikët dhe OSHC-të për të shkëmbyer pikëpamje gjatë negociatave të buxhetit dhe për të monitoruar zbatimin e buxhetit;**
- **leksione të hapura në të gjitha Universitetet, në të gjithë vendin;**
- **diskutim i hapur në bashkitë më të vogla në vend;**
- **fushatë ndërgjegjësimi në të gjithë vendin dedikuar grupeve rinore (Organizatrat rinore, Këshillat Rinor, etj.);**
- **sigurimi i trajnimeve për OSHC-të për të mundësuar një kuptim më të mirë të procedurave dhe raporteve të planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit.**

### **Detyrat paraprake që duhen arritur**

- Të përfshihen në Propozimin për zbatimin e Buxhetit të dhëna për gjendjen financiare të qeverisë dhe të dhëna për parashikimin makroekonomik;
  - Të përfshihet në Raportin e Fundvitit krahasimet ndërmjet vlerësimeve të huamarrjes dhe rezultateve aktuale, krahasimet midis rezultateve të planifikuara jofinanciare dhe rezultateve aktuale, dhe krahasimet midis parashikimit fillestar makroekonomik dhe rezultateve aktuale;
  - Përmirësimi i gjithëpërfshirjes së Rishikimit Gjysmëvjetor duke përfshirë parashikimin e përditësuar makroekonomik për vitin buxhetor në vijim, si dhe vlerësimet e shpenzimeve, huamarrjes dhe borxhit dhe informacion më të detajuar mbi të ardhurat (kategoritë dhe burimet individuale) për të gjithë vitin;
  - Të identifikohen nevojat e publikut për informacion buxhetor përpara publikimit të buxhetit qytetar, publikimi i tij nëpërmjet metodave shpesh të shpërndarjes (p.sh. billboard, programe radiofonike) dhe publikimi i dokumenteve të thjeshtuara buxhetore për fazat shpesh të procesit buxhetor.
- Shpjegim se si OSHC mund të kontribuojë në propozimet e dhëna:

Dhënia e idesë së propozimit

Implementimi

Ndërgjegjësimi

Financimi i një aktiviteti/iniciative konkrete

Tjetër (Një OSHC kontribuon në propozimet e paraqitura duke ofruar fillimisht idenë e propozimit. Miratimi i idesë së propozimit do të thotë se propozimi do të financohet konkretisht. Angazhimi i OSHC-ve vazhdon me zbatimin e aktiviteteve, duke i monitoruar ato në vazhdimësi. Për matjen e arritjes së objektivave kryhen vlerësime të ndërmjetme, duke u përmbledhur në mënyrë të përgjithshme në raportimin përfundimtar.)

## **Instituti i Politikave të Qëndrueshme**

- Prioritet / angazhim për tu përfshirë në Planin e Veprimit 2022-2024 për OGP paraqitet si mëposhtë:

### **Krijimi i një platforme edukimi financiar**

Të krijohet një mekanizëm/strukturë e dedikuar për edukimin financiar publik me qëllim shpërndarjen e njohurive / edukimin e publikut të gjërë, Organizatave të Shoqërisë Civile, studentëve, akademikëve si dhe nëpunësve civilë në nivel qendror apo vendor lidhur me shtyllat kryesore të Financave Publike: kuadri makroekonomik, planifikimi i mirëintegruar i buxhetit dhe investimeve, mobilizimi i të ardhurave, zbatimi efektiv i buxhetit, transparencë e financave publike, kontrolli i brendshëm financiar, dhe mbikëqyrja e jashtme efektive e financave publike.

Përsa më sipër është e rëndësishme ngritja e kësaj platforme për ti ndihmuar individët për të zgjeruar njohuritë themelore dhe për të kuptuar termat financiare bazë, karakteristikat e shërbimeve dhe produkteve financiare si dhe të ketë qëndrim dhe sjellje pozitive në menaxhimin e financave, kursimeve, investimeve, etj. Vendime të mirë-informuara mund të merren vetëm nëse individët janë në gjendje të kuptojnë veçoritë e produkteve dhe shërbimeve financiare.

- Shpjegim se si OSHC mund të kontribuojë në propozimet e dhëna:

OJF mund të kontribuojnë duke organizuar aktivitete ndërgjegjësuëse dhe informuese tek grupi i synuar.

Ne jemi angazhuar në projekte mbi edukimin financiar për nxënësit e gjimnazeve të Tiranës. Projektet tona kanë informuar gjimnazistët për aspekte të ndryshme të edukimit financiar, lidhur me të ardhurat, shpenzimet, buxhetimin, sigurinë e financave personale, marrjen hua, etj

Kështu që, ne mund të kontribuojmë duke informuar publikun e gjërë dhe grupe të synuara specifike mbi koncepte të menaxhimit të financave publike. Informacioni mund të shpërndahet nëpërmjet seminareve, trajnimeve, broshurave informuese si fizike ashtu dhe elektronike, prodhimi i spoteve informuese mbi financat publike, trajnimi i medias dhe gazetarëve për çështjet e sipërpërmendura të financave publike, informimi i studentëve, grupeve vulnerabël, asistencë për aktet që ndahen për konsultim publik duke rritur



kapacitetet e publikut për të dhënë mendimin e tij për projektaktet në fushën e financave publike.

OJF mund të asistojnë MEF për hartimin e një plan veprimi për të rritur transparencën fiskale dhe rritjen e angazhimit të publikut në këto çështje.

### **Sustainable Finance and Innovation Centre**

- Propozim për vendosjen e një angazhimi të ri në fushën e Transparencës fiskale
  - **Krijimi i synopseve me terminologji specifike dhe informacione bazike me qëllim shpërndarjen në auditore**
  - **Aktivitete ndërgjegjësimi për target audiencat e synuara**
  - **Trajnim edukues mbi shtyllat kryesore të manaxhimit të financave publike**
  - **Seanca këshillimi fiskal për target audiencat e synuara (SME, start-up, etj) pa pagesë online.**
  - **Organizimi i një seri podcast për të trajtuar aspekte të ndryshme të politikave fiskale.**
- Shpjegim se si OSHC mund të kontribuojë në propozimet e dhëna:

Dhënia e idesë së propozimit  
Implementimi  
Ndërgjegjësimi

### **Save the Children**

- Propozimi për zhvillimin e aktiviteteve brendave kornizave të komponentit II të Planit të Veprimit “Transparenca Buxhetore”.

Titulli i Iniciativës:

**Tur informues dhe edukativ mbi fushën e financave publike me fokus gjeneratat e reja dhe organizatat e shoqërisë civile.**

Qëllimi i iniciativës:

- Ngritja e kapaciteteve të nxënësve të shkollave profesionale, gjimnazeve dhe organizatave lokale mbi sistemin buxhetor dhe sistemet e PFM në përgjithësi, hapat e këtij procesi, aktorët e përfshirë etj, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre mbi fushën e financave publike dhe forcimin e rolit të tyre si qytetarë aktiv.

Objektivi kryesor:

- Npërmjet turit të aktiviteteve synohet forcimi i rolit të nxënësve si qytetarë aktiv por edhe organizatave lokale me qëllim përmirësimin e procesit të lloogarithënies së institucioneve buxhetore si përdorues të fondeve publike.

## Ministri Shtetit per Rinine dhe Femijet (2 angazhime prioritare)

1. Rishikimi i Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”
2. Ngritja e Bazës së të Dhënave për organizatat rinore.

Në përputhje me udhëzimet e paketës metodologjike për hapat dhe procedurat që duhet të ndiqen nga institucionet shtetërore dhe partnerët e jashtëm për propozimin e angazhimeve të Planit Kombëtar të Veprimit 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (en:OPG),Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF)dhe organizatat e shoqërisë civile rinore dhe organizatat e shoqërisë civile për të rinjtë ndërmorën procesin e bashkë-bërjes për nismat në fushën e rinisë.

### Faza e I. Fillimi i bashkë-bërjes (co-creation).

Bazuar në vlerësimin mbi objektivat e nismës së Partneritetit për Qeverisje të Hapur, MSHRF identifikoi dy angazhime potenciale për tu përfshirë në Planin Kombëtar të Veprimit 2022-2024, përkatësisht: *Rishikimi i Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”* dhe *Ngritja e Bazës së të Dhënave për Rininë*.

1. *Rishikimi i Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”*.

Ligji 45/2016 është mekanizmi ligjor kryesor për rregullimin në mënyrë formale të vullnetarizmit në Republikën e Shqipërisë. Neni 2 i Ligjit 45/2026 parashikon shprehimisht synimin për rregullimin ligjor të vullnetarizmit, me qëllim *rritjen e angazhimit qytetar dhe rritjen e pjesëmarrjes së individëve në jetën sociale* për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet, si dhe *zhvillimin e vlerave të solidaritetit njerëzor*.

Në rrjet i gjerë organizatash të shoqërisë civile në Shqipëri ka ndërmarrë gjatë viteve 2020 dhe 2021 një vlerësim strukturor të Ligjit 45/2026, si dhe zbatimit dhe ndikimit të tij duke arritur në përfundimin që ky ligj nuk ka arritur të përmirësojë infrastrukturën e vullnetarizmit dhe krijimin e një mjedisi më mundësues për sektorin në Shqipëri dhe ka vënë në pah problematika të shumëfishta lidhur me aspekte të veçanta të tij si njohja e punës vullnetare, kontraktimi dhe regjistrimi i vullnetarëve, kostot e sigurimit të tyre, etj.

Me qëllim diskutimin dhe adresimin e të gjitha problematikave në një proces eventual rishikimi të Ligjit, Znj. Bora Muzhaqi, Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Znj. Olta Manjani, Zv. Ministrëri Financave dhe Ekonomisë dhe Z. Kleviz Hysa, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive zhvilluan më datë 29 mars 2022 një takim online me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile ku përfshiheshin: Qendra Kombëtare Burimore e Shoqërisë Civile, Organizata Përtej Barrierave, World Vision, Korpusi i Vullnetarëve, Arka, Qendra Rinore Vlorë dhe Qendra Progres dhe Zhvillim. Një takim i dytë mes institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile u organizua më datë 22 Prill 2022, pranë zyrave të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive ku u dakordësua nevoja për rishikimin tërësor të ligjit dhe që ky proces rishikimi të bëhej si një aktivitet i përbashkët mes MSHRF, MFE, AKPA dhe organizatave të shoqërisë civile, për të përdorur të gjitha burimet e disponueshme dhe të dhënat e mbledhura përgjatë dy viteve të fundit.

## 2. Ngritja e Bazës së të Dhënave për Rininë.

Ligji nr. 75/2019 “Për rininë” ka përcaktuar detyrimin për ngritjen e bazës së të dhënave për rininë si një instrument i nevojshëm për të siguruar informacion të përditësuar në lidhje me situatën dhe nevojat e të rinjve në vend, si edhe për të mbështetur procesin e planifikimit, mbikëqyrjes, administrimit dhe vlerësimit të politikave rinore në nivel qendror dhe vendor.

Këshilli i Ministrave përmes vendimit Nr. 833, datë 24.12.2021, “Për Mënyrën e Ngritjes, Administrimit, Mirëmbajtjes së Bazës së të Dhënave për Rininë, si dhe mënyrën e Ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të Dhënave Shtetërore”, i ka hapur rrugë ngritjes së Bazës së të Dhënave për Rininë si regjistër elektronik për rininë (RER) që do administrohet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe do të ndërlihet me bazat e tjera shtetërore si: Regjistri gjyqësor për regjistrimin e OJF-ve, të dhënat e pronarëve përfitues, regjistri tatimor, sistemi i informacionit të planifikimit të integruar (SIPI).

Gjithashtunë Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-29 dhe planin e saj të veprimit miratuar me VKM Nr.692, datë 26.10.2022, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe planit të veprimit 2022-2029” është parashikuar rëndësia e ngritjes së këtij instrumenti, përmes një masë të veçantë nr.1.3.3. Në përputhje me ligjin nr.75, datë 04.11.2019 “Për Rininë” zhvillohet baza e të dhënave për organizatat rinore dhe për të rinjtë duke përfutuar edhe nga proceset e digjitalizimit të shërbimeve publike.

Referuar VKM Nr. 833, datë 24.12.2021, të gjithë të rinjtë, organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë në vend dhe diasporë, organizata Kombëtare Përfaqësuese për Rininë do të mund të regjistrohen në bazën e të dhënave për rininë dhe do të mund të aksesojnë si lexues të dhënat në RER duke dërguar kërkesën për informacion publik pranë AKR-së.

Të dhënat e mbledhura nga RER-i do të përdoren nga Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët për përmbushjen e përgjegjësiave të tyre institucionale si vlerësimin e situatës së të rinjve në vend dhe zbatimin e politikave rinore në vend bazuar mbi evidenca.

Gjithashtu të rinjtë, organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë në vend dhe diasporë do të mund të përdorin të dhënat nga RER-i për të mbështetur kërkime shkencore e statistikore, analiza, vlerësime apo projekte të ndryshme që zbatohen në fushën e rinisë duke lehtësuar angazhimin dhe kontributin e tyre në mbështetje të të rinjve në vend. Shërbime të tjera publike që parashikohen të mbështeten mbi bazën e të dhënave për rininë përfshijnë menaxhimin e procesit të thirrjeve vjetore për grantin shtetëror të rinisë nga AKR, menaxhimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës nga MSHRF, etj.

Me qëllim diskutimin e nevojave dhe sugjerimeve të shoqërisë lidhur me procesin e ngritjes së bazës së të dhënave për rininë u organizua më datë 12.06.2022, në ambientet e Kryeministrit takimi mes Znj. Bora Muzhaqi, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, dhe Z. Alqi Kushi, Drejtori Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile ku përfshiheshin: Scidev, Help in Albania, Roma Active Albania, ELSA Albania, UNA Albania, Qendra Youth Act, Futural Ngo, Perspektiva, LC.Impact, INAC Albania, EDYN Albania, Rrjeti i Profesionistëve të Rinj, New Vision, Qendra për Zhvillim dhe Integrim, ORBIS, RAYS, Qendra Për Progres Rinor, New Age - Qendra Rinore Kuçovë, Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri, Rrjeti Asan, Këshilli Shqiptar për Problemet e Lojërave të Fatit – ACPG, Epoka e Re, Qendra Rinore Vlorë, Kongresi Rinor Kombëtarë.

Gjatë këtij takimi, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët informoi përfaqësuesit e OSHC-ve pjesëmarrëse mbi procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit të PQH-së 2022-2024 dhe mundësinë e përfshirjes së kësaj nisme si angazhim i ri në këtë plan.

## Faza e II. Publikimi i pyetësorit Online.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përgatiti pyetësorin për konceptimin e masave prioritare në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2022-2024 të Partneritetit për Qeverisje të Hapur dhe e publikoi për konsultim të hapur me institucionet publike, OSHC-të, grupet e interesit dhe publikun e gjerë në faqen zyrtare elektronike:

<https://riniafemijet.gov.al/publikohet-pyetesori-per-bashke-berjen-e-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur/>

Pyetësori i cili qëndroi i hapur gjatë periudhës 11-18 janar 2022, i dha mundësi publikut dhe partnerëve të jashtëm të shpreheshin lidhur me përshtatshmërinë e propozimeve për Rishikimin e Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin” dhe Ngritjen e Bazës së të Dhënave për Rininë apo për të propozuar angazhim tjetër në fushën e rinisë për përfshirje në plan.

Pyetësori u plotësua nga 8 organizata të shoqërisë civile, gjetjet dhe rekomandimet e të cilave janë përmbledhur si vijon:

**PROPOZIMI 1** -Në lidhje me përfshirjen e “Rishikimit të Ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin” si angazhim në planin e veprimit, nga aktorët e përgjigjur:

- 80% ishin dakord për të kryer procesin e rishikimit të ligjit në fjalë;
  - 20% ishin pjesërisht dakord për të kryer procesin e rishikimit të ligjit.
- ⇒ Ata **sugjeruan** krijimin e një statusi të zyrtarizuar të vullnetarit dhe kryerjen e pagesave shoqërore/shëndetësore nga të dyja palët, në mënyrë që OSHC-të të mos rëndohen financiarisht.

**PROPOZIMI 2** –Në lidhje me përfshirjen e “Ngritjes së Bazës së të Dhënave për Rininë” si angazhim në planin e veprimit, aktorët e përgjigjur u shprehën se ishin plotësisht dakord.

**PROPOZIMI 3** –Në lidhje me propozimet të tjera për vendosjen si një angazhimi të ri në fushën e rinisë, në planin e veprimit, aktorët e përgjigjur dhanë këto propozime:

- Vendosjen e kontributeve vullnetare të të rinjve në OSHC si kriter plotësues për pjesëmarrjen e tyre në Universitet;
- T’i jepet fokus dhe rëndësi më e madhe nismave dhe projekteve që trajtojnë shëndetin mendor tek të rinjtë, duke i dhënë atyre mundësinë të angazhohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në nisma të tilla në moshë relativisht të hershme;
- Puna rinore të jetë një nga angazhimet e domosdoshme në fushën e rinisë;
- Digjitalizimi i orës mësimore të jetë një ndër pikat kyçe në zhvillimin e të rinjve pasi do të kthehej në një aset për ta në formimin profesional në vitet e mëvonshme;
- Angazhimi i të rinjve në strukturat e institucioneve të arsimit të lartë në mënyrë që të arrihet përfshirja dhe fuqizimi rinor në përmirësimin e universiteteve si dhe krijimi i forumeve aktive ose një formë tjetër organizimi e cila gëzon të drejta mbi informimin dhe propozimet që lidhen me universitetet;

- Përfshirja e të rinjve që në moshën 16 vjeçare në tregun e punës si vullnetarë apo profesionistë, si një mënyrë për t'i ndihmuar dhe mësuar me sensin e përgjegjësisë dhe ndërgjegjësimin social që të rinjtë marrin nga ky proces. Mundësitë për punësimin e të rinjve duhet të jenë në fokus të politikave të rinisë.

**PYETJA 4** -Në lidhje me përfshirjen e mëparshme në nisma dhe iniciativa që informojnë mbi aktivizimin e të rinjve dhe vullnetarizmin, të gjitha aktorët që plotësuan pyetësonin janë shprehur se kanë qenë pjesë e nismave dhe iniciativave të tilla. Disa prej nismave/angazhimeve të reja që sugjerohen të përfshihen në plan në kuadër të aktivizimit të të rinjve dhe vullnetarizmit tyre janë:

- Përfshirja e grupeve të marginalizuara në këto nisma (p.sh. Komuniteti Rom);
- **“Dita e Solidaritetit dhe Aktivizmit Social”** është një nismë e cila jep ndikim të drejtpërdrejtë tek të rinjtë. Krijimi i një rrjeti të rinjsh i cili më pas konkludohet në angazhimin e nismave sociale me në fokus shpërndarjen e informacionit tek bashkëmoshatarët e tyre më pak të përfshirë mbi të gjitha çështjet dhe problematikat që prekin rininë.

**PYETJA 5** - Në lidhje me përfshirjen e mëparshme në nisma dhe iniciativa që informojnë mbi të dhënat dhe studimet për rininë subjektet janë shprehur se:

- 50% prej tyre janë përfshirë në nisma dhe iniciativa që informojnë mbi të dhënat dhe studimet për rininë;
- 50% prej tyre nuk kanë marrë pjesë në nisma të tilla.

⇒ **Sugjerime:** Krijimi i hapësirave virtuale si grupe shoqërore në rrjete sociale (Facebook, WhatsApp, etj.) për publikimin e informacioneve në lidhje me mundësi punësimi, aplikime të ndryshme, praktika profesionale, etj.

**PYETJA 6** -Në lidhje me pjesëmarrjen aktive në aktivitete edukuese dhe informative mbi aktivizimin e të rinjve dhe vullnetarizmin në vend, aktorët e pyetur shprehen se:

- 90% prej tyre kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në aktivitete edukuese dhe informative mbi aktivizimin e të rinjve dhe vullnetarizmin në vend;
- 10% janë shprehur se nuk kanë qenë pjesë e aktiviteteve të lartpërmendura.

- **Sugjerime:**

- ⇒ Përmirësimi i kuadrit ligjor në mënyrë efektive që të nxisë pjesëmarrjen vullnetare në aktivitete;
- ⇒ Ndërturja e kurseve profesionale me vullnetarizmin, si një mënyrë më efektive dhe efçente për përfshirjen e të rinjve në këtë fushë;
- ⇒ Ngritja e kontakteve me institucionet e shërbimeve sociale dhe OSHC-ve si një mënyrë mëdrejtpërdrejtë informimi mbi komunitetet vulnerabel të cilat mund të kenë nevojë për vullnetarë në funksione si: shpërndarje ndihmash, mbledhje të dhënash, etj.;
- ⇒ Organizimi i mbledhjeve mujore në ambientet shkollore dhe të fakulteteve mes të rinjve dhe OSHC-venë qytetet përkatëse, ku të rinjtë njihen me mundësitë e realizimit të orëve vullnetare pranë institucioneve apo shtresave të marginalizuara të shoqërisë;



⇒ Krijimi i konceptit *“Dita e Vullnetarizmit”* në të cilën të rinjtë pranojnë të punojnë një ditë pranë institucioneve dhe OSHC-ve të ndryshme, pagesa e të cilëve do të shkojë për nisma të tjera rinore në mënyrë që të krijohet një frymë bashkëpunimi dhe network-u cilësorë mes tyre.

**PYETJA 7** -Në lidhje me pjesëmarrjen aktive në aktivitete edukuese dhe informative mbi të dhënat dhe studimet për rininë, aktorët e pyetur shprehën se:

- 50% e tyre kanë qenë pjesëmarrës aktiv në këto aktivitete edukuese dhe informative;
- 50% e tyre nuk kanë marrë pjesë në aktivitetet e lartpërmendura.

⇒ Në lidhje me *sugjerimet* e bëra për vendosjen e aktiviteteve të reja mbi të dhënat dhe studimet për rininë, në kuadër të Planit Kombëtar OGP 2022 – 2024, aktorët janë shprehur si më poshtë vijon:

- Studimi i të rinjve mbi konsumin e tyre ndaj materialeve mediatike;
- Realizimi i mbledhjes së të dhënave të të rinjve mbi median që konsumojnë dhe impaktin që ato kanë mbi ta.

**PYETJE 8** – Në lidhje me shpjegimin se si OSHC/grup i interesuar mund të kontribuojë në propozimet e dhëna më sipër, aktorët janë shprehur si më poshtë vijon:

- Organizimi i mbledhjeve mujore pranë institucioneve arsimore në formën e një partneriteti mes të rinjve, OSHC-ve dhe institucioneve arsimore;
- Shkëmbimet e informacionit mes të rinjve dhe OSHC-ve nëpërmjet Bazës së të Dhënave për Rininë praktikë mirë pune;
- Mbledhja e të dhënave mbi konsumin e materialeve mediatike që të rinjtë bëjnë mund të realizohet fillimisht në fakultete për të krijuar një bazë të dhënash që mund të na orientojnë lidhur me këtë çështje.

### **Faza e III. Konsultimi i draft-listës me prioritete.**

Në përfundim të procesit të propozimit dhe konsultimit të prioriteteve për fushën e rinisë me organizatat e shoqërisë civile për të rinjtë/rinore, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët vlerëson nismën për *Ngritjen e Bazës së të Dhënave për Rininë* si nisma me përshtatshmërinë dhe me rëndësinë më të lartë për tu përfshirë në Planin Kombëtar të Veprimit për PQH-në 2022-2024.

Më datë 20.01.2022 u mbajt takimi online me pjesëmarrjen e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Drejtoritë Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, Drejtorit të Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve, stafit të MSHRF-së dhe AKR-së dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile ku përfshiheshin: Qendra Rinore Vlorë, Kongresi Rinor Kombëtar, Epoka e Re, Scidev, Help in Albania, Roma Active Albania, UNA Albania, INAC Albania, New Vision, ORBIS, Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri dhe Këshilli Shqiptar për Problemet e Lojërave të Fatit – ACPG.

Ky takim shërbeu për të diskutuar dhe dakordësuar propozimin e nismës për *Ngritjen e Bazës së të Dhënave për Rininë* si angazhim në fushën e rinisë në Planin Kombëtar të Veprimit të PQH-së 2022-2024 dhe ngritjen e një grupi të përbashkët pune me pjesëmarrjen e MSHRF, AKR, AKSHI dhe OSHC rinore dhe për të rinjtë që do të punojnë për realizimin e angazhimit të ngritjes së bazës së të dhënave për rininë.

## Ministria e Mbrojtjes (3 angazhime prioritare)

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi kontributin e Mbrojtjes në drejtim të sigurimit dhe ruajtjes së cilësisë së jetës së qytetarit, si dhe në bashkëpunim me aleatët dhe partnerët, në ndërtimin e një mjedisi sigurie më të qëndrueshëm.
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transformimin e instrumentit ushtarak dhe krijimi i një sistemi mbrojtës të qëndrueshëm bazuar në inovacionin teknologjik.
3. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi rëndësinë e dialogut në hartimin e politikave dhe bashkëpunimit të ngushtë civilo-ushtarak.

## Evidencat e një/dy takimeve me OSHC-të, për konsultimin e prioriteteve në kuadër të inicimit të procesit të Planit Kombëtar të Veprimit 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur.

Në datën 8 janar Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i shoqëruar edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Arben Kingji dhe drejtori i Përgjithshëm i AKMC, Haki Çako prezantuan në një konferencë për mediat dhe organizata të shoqërisë civile arritjet gjatë vitit 2022 si dhe objektivat e projektet e reja për vitin 2023 në fushën e Mbrojtjes si edhe të Mbrojtjes Civile.

Në këtë takim ishin të pranishëm përfaqësues nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë (SHKURSH), Aleanca Kombëtare e ushtarakëve të Shqipërisë (AKUSH), Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve Xhenier të Shqipërisë, Ushtarët e Dëmtuar dhe të Aksidentuar gjatë Shërbimit të Detyrueshëm Ushtarak, Organizata e Veteranëve të LANC të Popullit Shqiptar (Komiteti i veteranëve), Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës (OBVL), Organizata Kombëtare e Familjeve të LANC-it dhe Dëshmorëve të Tjerë të Atdheut si dhe ekspertë të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes.

Gjatë prezantimit të objektivave për vitin 2023, ministri i Mbrojtjes ftoi të pranishmit në bashkëpunim aktiv dhe dhënie kontributi në realizimin e tyre, duke theksuar nevojën e bashkëpunimit të ngushtë me shoqërinë civile veçanërisht në hartimin e politikave të mbrojtjes dhe sigurisë, të cilat do të jetësohen përgjatë këtij viti.

Gjithashtu, përfshirja për herë të parë e Ministrisë së Mbrojtjes në procesin hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur, përkon edhe me objektivat strategjike të Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2022-2025 të cilat janë:

1. Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike;
2. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së Ministrisë së Mbrojtjes;
3. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore;
4. Forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm;
5. Forcimi i integritetit në operacione dhe misionet ndërkombëtare;

Përmes objektivit “Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike” synohet pjesëmarrja në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave të mbrojtjes dhe sigurisë të një sërë aktorëve, qofshin institucione shtetërore apo

media, grupe interesi dhe shoqëri civile në përgjithësi, duke garantuar që politikat dhe vendimet në lidhje me mbrojtjen të jenë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat strategjike, dhe që problemet të mund të identifikohen që në një fazë të hershme.

Ky objektivi përmban një numër prej 4 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira për vitin 2023 nëpërmjet 7 aktiviteteve. Masa 1.6.1 parashikon hartimin e një programi vjetor për angazhimin e OSHC-së dhe organizimi i takimeve me OSHC-në.

Bashkëlidhur linku i takimit të hapur të datës 8 janar 2023:

<https://www.mod.gov.al/newsroom-2/5870-arritjet-e-2022-dhe-objektivat-e-2023-peleshi-fuqizojme-sigurine-kibernetike-rrisim-pagat-e-ushtarakeve>

Video e plotë e takimit “Mbrojtja dhe forcat tona të armatosura 2022-2023. Arritjet, sfidat dhe objektivat”:

<https://www.facebook.com/MinistriaMbrojtjes>

### **Mbi rezultatet e pyetësorit paraprak për konceptimin e masave prioritare në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur.**

Në datën 13 janar Ministria e Mbrojtjes shpall për konsultim të hapur me institucionet publike, OSHC-të, grupe interesi dhe publikun e gjerë, pyetësorin paraprak për konceptimin e masave prioritare në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit, 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur.

Ky pyetësor u hartua nga Drejtorja e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes, në konsultim me Drejtorinë e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, dhe pas miratimit të tij në datën 13 janar Ministria e Mbrojtjes e shpall për konsultim të hapur me institucionet publike, OSHC-të, grupe interesi dhe publikun e gjerë.

Këtë pyetësor mund ta gjeni në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes: <https://www.mod.gov.al/newsroom-2/njoftime/5877-pyetesor-ne-kuader-te-procesit-te-bashke-berjes-se-masave-prioritare-te-angazhimeve-te-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur-en-ogp>

Si dhe gjithashtu në linkun e OGP: <https://ogp.gov.al/faqe/procesi-i-bashke-krijimit>  
[https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSeNqrSKftY2Quw6Hiv\\_yhIKzugNuwpOsJn9tEhZe49ZQLX2w/viewform](https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSeNqrSKftY2Quw6Hiv_yhIKzugNuwpOsJn9tEhZe49ZQLX2w/viewform)

Kanëshprehur dakortësinë mbi prioritetet e MM-së me plotësimin e pyetësorit Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë (SHKURSH), Aleanca Kombëtare e ushtarakëve të Shqipërisë (AKUSH), Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve Xhenier të Shqipërisë, Ushtarët e Dëmtuar dhe të Aksidentuar gjatë Shërbimit të Detyrueshëm Ushtarak, Organizata e Veteranëve të LANC të Popullit Shqiptar (Komiteti i veteranëve), Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës (OBVL), Organizata Kombëtare e Familjeve të LANC-it dhe Dëshmorëve të Tjerë të Atdheut .

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjeska sugjeruar shtimin e prioritetit: *Ndërtimi dhe konsolidimi i kuadrit, kapaciteteve dhe praktikave për ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile në funksion të interesit publik, në rolin e implementuesit.*





